



Electrolux



electrolux.com/register



EW8F348SCI

SQ Udhëzimet për përdorim | **Lavatriçe**



Mirë se vini në Electrolux! Faleminderit që keni zgjedhur pajisjen tonë.



Në përpjekjet tona për të qenë ekologjikë, ne jemi duke reduktuar asetet e letrës dhe po ofrojmë manuale të plota përdorimi në internet. Aksesoni manualin tonë të plotë të përdorimit në **electrolux.com/manuals**



Merrni këshilla të përdorimit, broshura, informacion për ndreqjen e problemeve, shërbimin dhe riparimin në **electrolux.com/support**



Blini aksesore, pjesë konsumi dhe pjesë origjinale këmbimi për pajisjen tuaj në **electrolux.com/shop**

Rezervohet mundësia e ndryshimeve.

PËRMBAJTJA

1. TË DHËNA PËR SIGURINË.....	2
2. UDHËZIMET PËR SIGURINË.....	4
3. PËRSHKRIM I PRODUKTIT.....	6
4. TË DHËNAT TEKNIKE.....	8
5. INSTALIMI.....	8
6. PANELI I KONTROLLIT.....	19
7. ÇELËSI PËRZGJEDHËS DHE BUTONAT.....	21
8. PROGRAMET.....	24
9. WI-FI - KONFIGURIMI I LIDHJES.....	30
10. CILËSIMET.....	32
11. PËRPARA PËRDORIMIT TË PARË.....	33
12. PËRDORIMI I PËRDITSHËM.....	33
13. UDHËZIME DHE KËSHILLA.....	38
14. KUJDESI DHE PASTRIMI.....	40
15. ZGJIDHJA E PROBLEMEVE.....	47
16. VLERAT E KONSUMIT.....	51
17. SHQETËSIME MJEDISORE.....	52

1. TË DHËNA PËR SIGURINË



Përpara fillimit të instalimit dhe përdorimit të kësaj pajisje, lexoni me kujdes udhëzimet e dhëna.

Prodhuesi nuk është përgjegjës për lëndimet apo dëmet si rezultat i instalimit apo përdorimit të papërshtatshëm.

Gjithmonë mbajini udhëzimet në një vend të sigurt dhe ku mund të arrihen lehtë për t'iu referuar në të ardhmen.

1.1 Siguria e fëmijëve dhe personave vulnerabël

- Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijë të moshës 8 vjeç e sipër dhe persona me aftësi të kufizuara fizike, ndijimesh ose mendore ose që nuk kanë eksperiencë dhe njohuri, nëse këta mbahen nën mbikëqyrje ose udhëzohen për përdorimin e sigurt të pajisjes dhe i kuptojnë rreziqet e përdorimit.
- Fëmijët nga 3 deri në 8 vjeç dhe personat me aftësi të kufizuara shumë të theksuara dhe komplekse duhet të mbahen larg nga pajisja, përveçse kur mbahen nën monitorim të vazhdueshëm.
- Fëmijët më të vegjël se 3 vjeç duhet të mbahen larg nga pajisja, përveçse kur mbikëqyren në mënyrë të vazhdueshme.
- Fëmijët duhet të monitorohen për t'u siguruar se nuk luajnë me pajisjen.
- Mbajeni të gjithë paketimin larg nga fëmijët dhe hidheni atë siç kërkohet.
- Mbajini detergjentet larg fëmijëve.
- Mbajini fëmijët dhe kafshët shtëpiake larg pajisjes, gjatë kohës që dera e saj është e hapur.
- Nëse pajisja ka një mekanizëm për sigurinë e fëmijëve, ai duhet aktivizuar.
- Fëmijët nuk duhet të kryejnë pastrimin dhe mirëmbajtjen e pajisjes pa mbikëqyrje.

1.2 Siguria e përgjithshme

- Kjo pajisje është vetëm për larjen dhe tharjen e rrobave të llojit shtëpiak që lahen në lavatriçe.
- Kjo pajisje është krijuar për përdorim shtëpiak në ambient të brendshëm.
- Kjo pajisje mund të përdoret në zyra, dhoma hoteli, dhoma bujtine, dhoma hoteli rural, si dhe në vende të ngjashme ku përdorimi nuk tejkalon (mesatarisht) nivelet e përdorimit shtëpiak.
- Mos i ndryshoni specifikimet e pajisjes.

- Ngarkesa maksimale e pajisjes është 8.0 kg. Mos tejkaloni ngarkesën maksimale të çdo programi (referojuni kapitullit "Programet").
- Presioni i punës i ujit në pikën e hyrjes së ujit nga lidhja e daljes duhet të jetë midis 0,5 bar (0,05 MPa) dhe 10 bar (1.0 MPa).
- Vrima e ajrimit në pjesën e poshtme nuk duhet të mbulohet nga tapeti, rrugica apo ndonjë mbulesë tjetër dysHEMEJE.
- Pajisja duhet të lidhet me furnizimin me ujë duke përdorur kompletin e ri të tubave që vjen me pajisjen ose komplete të tjera të reja tubash të ofruara nga qendra e autorizuar e shërbimit.
- Zorrat e vjetra nuk duhen ripërdorur.
- Për të shmangur rreziqet elektrike, nëse kabloja e energjisë elektrike është e dëmtuar, ajo duhet ndërruar nga prodhuesi, qendra e autorizuar e shërbimit ose persona me kualifikim të ngjashëm.
- Përpara se të kryeni shërbim mirëmbajtjeje, çaktivizoni pajisjen dhe hiqni spinën nga priza.
- Mos përdorni spërkatës me ujë me presion të lartë dhe/ose avull për të pastruar pajisjen.
- Pastrojeni pajisjen me copë të butë e të njomë. Përdorni vetëm detergjente neutrale. Mos përdorni produkte gërryese, materiale të ashpra pastruese, tretës ose objekte metalike.

2. UDHËZIMET PËR SIGURINË

2.1 Instalimi



Instalimi duhet të jetë në përputhje me rregulloret përkatës kombëtare.

- Hiqni të gjithë ambalazhin dhe bulonat e transportit duke përfshirë furçën prej gome dhe distancatorin plastik.
- Mbajini bulonat e transportit në një vend të sigurt. Nëse pajisja do të transportohet në të ardhmen, ata duhet të vendosen për të

bllokuar kazanin për të parandaluar dëmtimet e brendshme.

- Gjithmonë bëni kujdes kur e lëvizni pajisjen sepse është e rëndë. Përdorni gjithnjë doreza sigurie dhe këpucë të mbyllura.
- Ndiqui udhëzimet e instalimit të dhëna me pajisjen.
- Mos e përdorni pajisjen përpara se ta instaloni në strukturën inkaso për arsye sigurie.
- Mos instaloni ose mos përdorni një pajisje të dëmtuar.

- Mos e instaloni ose mos e përdorni pajisjen kur temperatura mund të jetë më e ulët se 0°C ose kur ekspozohet ndaj kushteve atmosferike.
- Zona e dyshemesë ku do të instalohet pajisja duhet të jetë e sheshtë, e qëndrueshme, rezistente ndaj nxehtësisë dhe e pastër.
- Sigurohuni që ndërmjet pajisjes dhe dyshemesë të qarkullojë ajër.
- Pasi ta keni vendosur pajisjen në vendin e saj të përhershëm të punës, kontrolloni që të jetë saktësisht e niveluar me ndihmën e një niveli. Nëse jo, rregulloni këmbëzat siç duhet.
- Mos e instaloni pajisjen direkt mbi një piletë në dysheme.
- Mos spërkatni ujë mbi pajisje dhe mos e ekspozoni atë ndaj lagështirës së tepërt.
- Mos e instaloni pajisjen në një vend ku dera e pajisjes nuk mund të hapet plotësisht.
- Mos vendosni një enë të mbyllur për të grumbulluar ujin që mund të rrjedhë nën pajisje. Kontaktoni me Qendrën e Autorizuar të Shërbimit për t'u siguruar se cilët aksesore mund të përdoren.

2.2 Lidhja elektrike



PARALAJMËRIM!

Rrezik zjarri dhe goditjeje elektrike.

- PARALAJMËRIM: Kjo pajisje është krijuar për t'u instaluar / lidhur me një lidhje tokëzimi në ndërtesë.
- Përdorni gjithmonë një prizë të tokëzuar të instaluar si duhet.
- Sigurohuni që parametrat në pllakën e specifikimeve të përkojnë me vlerat elektrike të rrjetit elektrik.
- Mos përdorni përshtatës me shumë spina dhe kablo zgjatuese.
- Sigurohuni që të mos dëmtoni prizën dhe kabllo elektrike. Nëse kabloja elektrike duhet zëvendësuar, kjo duhet bërë nga Qendra jonë e autorizuar e shërbimit.
- Pajisjen futeni në prizë vetëm në fund të instalimit. Sigurohuni që spina të jetë e arritshme pas montimit të pajisjes.
- Mos e prekni kabllo elektrike ose spinën e rrymës me duar të lagura.

- Mos e shkëputni pajisjen nga rrjeti duke e tërhequr nga kabloja elektrike. Gjithmonë tërhiqeni kabllo elektrike duke e kapur nga spina.

2.3 Lidhja e shkarkimit të ujit

- Uji i hyrjes nuk duhet të kalojë 25 ° C.
- Mos u shkaktoni dëmtim tubave të ujit.
- Përpara lidhjes me tuba të rinj, tubat që nuk janë përdorur për një kohë të gjatë, aty ku janë kryer punime riparimi ose janë vendosur pajisje të reja (sahate uji, etj.), lëreni ujin të rrjedhë derisa të jetë i kthjellët dhe i pastër.
- Sigurohuni që të mos ketë rrjedhje të dukshme uji gjatë dhe pas përdorimit të parë të pajisjes.
- Mos përdorni zorrë zgjatuese nëse zorra e hyrjes së ujit është tepër e shkurtër. Kontaktoni me Qendrën e Autorizuar të Shërbimit për zëvendësimin e zorrëve të hyrjes së ujit.
- Gjatë shpaktimit të pajisjes, ka mundësi të shihni të derdhet ujë nga zorra e shkarkimit. Kjo ndodh për shkak të testimit të pajisjes me ujë në fabrikë.
- Ju mund ta zgjasni zorrën e kullimit në maksimumi 400 cm. Kontaktoni Qendrën e Autorizuar të Shërbimit për zorrën tjetër të kullimit dhe zgjatimin.
- Sigurohuni që rubineti të jetë i arritshëm pas montimit.

2.4 Përdorimi



PARALAJMËRIM!

Rrezik plagosjeje, goditjeje elektrike, zjarri, dëgjieje ose dëmtimi të pajisjes.

- Ndiqni udhëzimet e sigurisë në ambalazhin e detergjentit.
- Mos vendosni produkte që marrin flakë ose sende të lagura me produkte të ndezshme brenda, pranë pajisjes ose mbi të.
- Mos lani pëlhura që janë të ndotura shumë me vajra, graso apo substanca të tjera vajore. Mund të dëmtojë pjesët prej gome të pajisjes. Lajini paraprakisht me dorë këto pëlhura përpara se t'i ngarkoni në pajisje.

- Mos përdorni aroma rrobash për të shmangur rrezikun e dëmtimit të pjesëve plastike dhe prej gome të pajisjes.
- Mos e prekni xhamin e derës gjatë kohës që pajisja është në punë e sipër. Xhami mund të nxehet.
- Sigurohuni që të keni hequr të gjitha objektet metalike nga rrobat.

2.5 Shërbimi

- Për të riparuar pajisjen kontaktoni me qendrën e autorizuar të shërbimit. Përdorni vetëm pjesë rezervë origjinale.
- Ju lutemi vini re se vetëriparimi ose riparimi joprofesional mund të ketë pasoja sigurie dhe mund të zhvlerësojë garancinë.
- Pjesët e mëposhtme të këmbimit janë të disponueshme për të paktën 10 vjet pas daljes nga qarkullimi të modelit: motori dhe karbonçinat e motorit, transmisioni mes motorit dhe kazanit, amortizatorët dhe sustat, kazani i larjes, grupi i pasmë i kazanit dhe kushinetat përkatëse, ngrohësit dhe elementet e ngrohjes, duke përfshirë pompat e nxehtësisë, tubacionet dhe pajisjet përkatëse duke përfshirë zorrët, valvulat, filtrat dhe bllokuesit e ujit, qarqet elektrike, ekranet elektrike, çelësat e presionit, termostatat dhe sensorët, softuerët dhe firmuerët duke përfshirë softuerin e rivendosjes, derën, menteshën dhe guarnicionet e derës, guarnicionet e tjera, grupin e kyçjes së derës, mjetet periferike plastike si p.sh. foletë e detergjentit. Afati mund të jetë më i gjatë

në vendin tuaj. Për informacion të mëtejshëm, vizitoni faqen tonë të internetit.

- Ju lutemi vini re se disa nga këto pjesë këmbimi janë të disponueshme vetëm për riparuesit profesionistë, dhe se jo të gjitha pjesët e këmbimit u përshtaten të gjitha modeleve.
- Në lidhje me llambat brenda produktit dhe llambat e pjesëve të këmbimit të shitura veçmas: Këto llamba janë prodhuar për kushte ekstreme fizike në pajisjet elektroshtëpiake, si p.sh. temperaturë, dridhje, lagështirë, ose janë prodhuar për të sinjalizuar informacion rreth statusit të përdorimit të pajisjes. Ato nuk janë prodhuar për t'u përdorur në aplikacione të tjera dhe nuk janë të përshtatshme për ndriçim në ambiente shtëpiake.

2.6 Eliminimi i pajisjes

PARALAJMËRIM!

Rreziku i lëndimit ose mbytjes.

- Shkëputeni pajisjen nga rrjeti i furnizimit me energji dhe ai me ujë.
- Priteni kabllo e rrjetit elektrik pranë pajisjes dhe hidheni atë.
- Hiqni kapësen e derës për të parandaluar ngecjen e fëmijëve dhe të kafshëve shtëpiake brenda kazanit.
- Hidheni pajisjen në përputhje me kërkesat lokale për hedhjen e pajisjeve mbeturina elektrike dhe elektronike (WEEE).

3. PËRSHKRIM I PRODUKTIT

3.1 Veçoritë e veçanta

Lavatriça juaj e re plotëson të gjitha kërkesat bashkëkohore për trajtimin efikas të rrobave me konsum të ulët uji, energjie dhe detergjenti dhe tregon kujdes për pëlhurat.

- **Lidhja me Wi-Fi dhe Ndezja në distancë** ju mundëson të nisni një cikël, për të bashkëvepruar me lavatriçen tuaj dhe për të kontrolluar statusin e ciklit të larjes në telekomandë.
- **SteamCare Sistemi**, falë programeve të reja **Steam Cashmere** dhe **Steam**

FreshScent me avull ofron zgjidhjen e përkryer për freskimin edhe të rrobave më delikate pa larje. Përdorni fragrancën delikate të zhvilluar në mënyrë ekskluzive nga **Electrolux** për të shtuar një ndjesi të këndshme të rrobave të "sapo lara", përveç heqjes së aromave të këqija dhe rrudhave.

- **UltraCare Teknologjia** është projektuar për të mbrojtur fibrat e rrobave falë fazave përpara përzierjes që tretin fillimisht detergjentin dhe më pas zbutësin e rrobave në ujë përpara se të shpërndahen



nëpër rroba. Pranda çdo fibër merr kujdesin e nevojshëm.

- Avulli është një mënyrë e shpejtë dhe e lehtë për të rifreskuar rrobat. Programet delikate me avull heqin aromat e pakëndëshme dhe reduktojnë rrudhat në rrobat e thara prandaj u nevojitet pak hekurosje.

Plus Steam Opsioni e përfundon çdo cikël me avull delikat që zbut fibrat dhe redukton rrudhat e rrobave. Hekurosja do të jetë më e lehtë!


- Falë **Soft Plus opsionit**, zbutësi i rrobave shpërndahet në mënyrë të njëtrajtshme në rroba dhe depërton thellë fibrat e rrobave duke favorizuar një butësi të përkryer.
- **SensiCare System** dallon sasinë e ngarkesës së rrobave dhe përcakton kohëzgjatjen e programit brenda 30 sekondash. Programi i larjes është përshtatur në bazë të llojit dhe ngarkesës së rrobave pa konsumuar më shumë kohë, energji dhe ujë sesa nevojitet.

3.2 Përmbledhja e funksioneve të pajisjes



- 1 Suportet e menteshave
- 2 Foleja e detergjentit
- 3 Paneli i kontrollit
- 4 Pllaka magnetike
- 5 Doreza e derës
- 6 Etiketa e specifikimeve
- 7 Pllaka me rrahëse gome
- 8 Filtri i pompës së shkarkimit

- 9 Këmbët e përparme për nivelimin e pajisjes
- 10 Tubi i shkarkimit
- 11 Kordoni elektrik
- 12 Lidhja e tubit të furnizimit me ujë
- 13 Këmbët e pasme për nivelimin e pajisjes



Pllaka e të dhënave raporton:

- A. Kodi QR
- B. Emri i modelit
- C. Numri i produktit
- D. Specifikimet elektrike
- E. Numri serial

Skanoji **kodin QR** me kamerën për të shkarkuar aplikacionin tonë nga dyqani i aplikacioneve në pajisjen tuaj inteligjente dhe ndiqni hapat e kërkuar. Regjistroni produktin dhe përfitonit sa më shumë prej tij.

-  Aksesoni detajet e pajisjes tuaj, dokumentacion dhe artikuj sesi të përdorni veçoritë më të mira (Manuali i përdorimit është gjithashtu i disponueshëm në electrolux.com/manuals)
-  Merrni këshilla për përdorimin, zgjidhjen e problemeve, informacion për shërbimin dhe riparimin (gjithashtu të disponueshëm në electrolux.com/support)
-  Blini aksesorë, pjesë konsumi dhe pjesë këmbimi për pajisjen tuaj (gjithashtu të disponueshëm në electrolux.com/shop)

4. TË DHËNAT TEKNIKE

Përmasat	Gjerësia / Lartësia / Thellësia totale	59.6 cm /81.9 cm /55.3 cm
Lidhja elektrike	Tensioni Overall power Fuse Frekuenca	230 V 2100 W 10 A 50 Hz
Niveli i mbrojtjes kundër hyrjes së grimcave të ngurta dhe lagështisë i siguruar prej mbulesës mbrojtëse, përveç rasteve kur pajisjet e voltazhit të ulët nuk kanë mbrojtje nga lagështia		IPX4
Presioni i furnizimit me ujë	Minimal Maksimal	0.5 bar (0.05 MPa) 10 bar (1.0 MPa)
Furnizimi me ujë ¹⁾		Ujë i ftohtë
Ngarkesa maksimale	Të pambukta	8.0 kg

¹⁾ Lidheni zorrën e hyrjes së ujit me një rubinet me 3/4" filetimit.

5. INSTALIMI




PARALAJMËRIM!

Referojuni kapitujve për sigurinë.


5.1 Përgatituni për instalimin



Rekomandohet që instalimi të kryhet nga dy persona.



5.2 Pajisja është e pajisur me ...




5.3 Çpaketimi

⚠ PARALAJMËRIM!

Përdorni dorezat.

⚠ PARALAJMËRIM!

Hiqni të gjithë paketimin dhe bulonat e transportit përpara instalimit të pajisjes.



1. Vendosni dy elementet e paketimit në dyshe me poshtë pajisjes.


⚠ PARALAJMËRIM!

Rekomandohet shumë që ky veprim të kryhet nga dy persona.


2. Uleni me kujdes pajisjen nga pjesa e pasme.




Sigurohuni të mos dëmtoni zorrët.



3. Hiqni mbrojtësen nga pjesa e poshtme.




4. Kthejeni pajisjen në pozicion vertikal dhe hiqni mbrojtjen e prizës.




5. Hiqni kabllon e furnizimit me energji dhe zorrën e shkarkimit nga mbajtëset e zorrës.



Ka mundësi të shihni të derdhet ujë nga zorra e shkarkimit. Kjo ndodh për shkak të testimit të pajisjes me ujë në fabrikën e prodhimit.



6. Hiqni tre bulonat, mbajtëset e zorrës dhe distancatorët plastikë duke përdorur çelësin e dhënë me pajisjen.




7. Mbyllni vrimat me tapat plastike që do të gjeni në qesen e manualit të përdorimit. Vendosni tapën më të vogël **F** në vrimën e sipërme dhe dy tapat më të mëdha **G** në vrimat e poshtme.



Rekomandojmë që të mbani të gjithë ambalazhin dhe bulonat e transportit për çdo rast kur ju duhet ta lëvizni pajisjen.

5.4 Pozicionimi dhe nivelimi



1. Instalojeni pajisjen mbi një dysheme të fortë e të sheshtë.



PARALAJMËRIM!

Sigurohuni që tapetet të mos pengojnë qarkullimin e ajrit poshtë pajisjes.



Silleni pajisjen pranë zgavrës së mobilies përpara se ta niveloni atë. Për më shumë detaje, referojuni paragrafit "Montimi inkaso".

2. Lironi ose shtrëngoni këmbëzat për të rregulluar nivelin.




Rregullimi i duhur i nivelit të pajisjes parandalon dridhjet, zhurmat dhe lëvizjen e pajisjes kur është në punë.

Pajisja duhet të jetë e niveluar dhe e palëvizshme.




KUJDES!



Mos vendosni karton, dru apo materiale të tjera poshtë këmbëzave të pajisjes për të rregulluar nivelin.



5.5 Lidhja e zorrës dhe e kablllove



Zorra e futjes së ujit




1. Hiqni zorrën e hyrjes së ujit nga brenda kazanit.
2. Për të lidhur zorrën e hyrjes së ujit drejt drejtimit të duhur dhe me animin e duhur, kontrolloni pozicionin e rubinetit të ujit përpara se ta lidhni me pjesën e pasme të pajisjes.



Sigurohuni që zorra të mos jetë as e përthyer ose e shtypur, por as e tendosur.

3. Lidhni zorrën me pjesën e pasme të pajisjes. Mos e rrotulloni zorrën e hyrjes poshtë, por rrotullojeni majtas apo djathtas në varësi të pozicionit të rubinetit tuaj të ujit.
4. Lironi vidën unazë për ta fiksuar në pozicionin e duhur.



5. Lidhni zorrën e furnizimit me ujë te një rubinet uji me fileto 3/4.

⚠ PARALAJMËRIM!

Uji i hyrjes nuk duhet të kalojë 25 ° C.

⚠ PARALAJMËRIM!

Sigurohuni që të mos ketë rrjedhje nga bashkuesit.




Përdorni zorrën e dhënë bashkë me pajisjen.



Mos përdorni zorrë zgjatuese nëse zorra e hyrjes së ujit është tepër e shkurtër. Kontaktoni me qendrën e shërbimit për zëvendësimin e zorrës së furnizimit të ujit.

Shkarkimi i ujit

Tubi i shkarkimit mund të lidhet:




Në një tub mbështetës me vrimë ajrimi


Drejtëpërdrejt në një tub shkarkimi në një lartësi prej jo më pak se 60 cm (23,6") dhe jo më shumë se 100 cm (39,3").

Fundi i zorrës së kullimit duhet të jetë gjithmonë i ajrosur, d.m.th. diametri i brendshëm i tubit të shkarkimit (min. 40 mm - min. 1,6") duhet të jetë më i madh se diametri i jashtëm i tubit të shkarkimit.

Drejt një rubineti me gotë me ajrosje

Vendoseni tubin e shkarkimit në spigotë dhe shtrëngojeni me lidhësen e dhënë të kablos L. Sigurohuni që tubi i shkarkimit të krijojë një hark për të parandaluar që copëzat të futen në pajisje nga lavamani.






Drejt një tubi muri me ajrosje

Direkt në një tub shkarkimi të futur në murin e dhomës dhe të shtrënguar me lidhësen e dhënë të kabllos L.




Ju mund ta zgjasni zorrën e kullimit në maksimumi 400 cm. Kontaktoni qendrën e autorizuar të shërbimit për zorrën tjetër të shkarkimit dhe zgjatimin.


5.6 Montimi inkaso



Kjo pajisje është bërë për t'u ndërfutur me mobilet e kuzhinës. Shikoni dimensionet minimale të zgavrës në skica.




Nëse zorrët kalojnë prapa pajisjes, sigurohuni që të mos ketë asgjë që mbyll zgavrën e vogël të treguar me përmasat 50 x 50 mm.



Pajisja është e pajisur gjithashtu me një sfungjer adeziv **H** që mund ta gjeni brenda kazanit. Vendoseni atë në krye të pajisjes ku tregohet në skicë.

Kur niveloni pajisjen poshtë mobilies, MOS e shtypni sfungjerin.



Përpara se të vazhdoni me inkasimin e pajisjes, silleni atë pranë zgavrës dhe poziciononi paraprakisht zorrën e hyrjes, zorrën e shkarkimit dhe kabllot kryesore.


⚠ PARALAJMËRIM!

Sigurohuni që të mos jenë përthyer ose shtypur.

5.7 Përgatitja dhe montimi i derës së dollapit

Përmasat e derës së dollapit duhet të jenë:

- gjerësia min. 595 - maks. 598 mm;
- trashësia 16-22 mm.




Cilësimi i fabrikës


Pajisja është parapërgatitur si fillim për montimin e derës së dollapit me hapje nga e djathta në të majtë.




Zgjidhja më e mirë do të ishte vidhosja e menteshës së sipërme me vrimën e sipërme të pllakës së sipërme dhe menteshës së poshtme me vrimën e poshtme të pllakës së poshtme.




Ndryshimi i drejtimit të derës së dollapit
Kryejeni kthimin e drejtimit të derës së dollapit përpara se pajisja të inkasohet plotësisht.



Nëse dera duhet të hapet nga e majta në të djathtë, ktheni pozicionin e suporteve të menteshave **M** me pllakën magnetike **N** dhe pllakën e poshtme **O**.



Sigurohuni që pllaka me magnetin të jetë në pozicionin e sipërm.




Përgatitja e derës së dollapit




Për vendosjen e derës rrafsh, rekomandohet që të kërkoni ndihmën e një profesionisti.

Bashkërenditeni saktësisht derën e dollapit me mobilien.

Matni distancën **X** për të rregulluar lartësinë e vrimës për të bërë rrafsh menteshën e sipërme. Qendra e vrimës **Y** duhet të jetë në të njëjtën lartësi me kalimin në suportin e menteshës.




Vendoseni pozicionin e vrimës së poshtme duke respektuar dimensionet dhe distancat e treguara në skicë (449 mm).
Rrafshoni vrimat.




Mentesha

Për të montuar menteshat është e domosdoshme të hapen dy vrima (dia. 35 mm, thellësia 12,5 - 14 mm në varësi të thellësisë së derës së dollapit) në anën e brendshme të derës. Menteshat do të fiksohen në derë përmes katër vidave të dhëna **A**.



Për ta bashkërenditur derën në mënyrë të përkryer, sigurohuni që ana e derës së dollapit të jetë paralele me anën e pajisjes dhe të respektojë këndin e duhur të hapjes (maks. 105 °C).





Montimi i derës

Fiksoni menteshat me suportet e menteshave në pajisje përmes dy vidave të dhëna **B**.



Menteshat mund të rregullohen për të kompesuar për trashësi të mundshme të pabarabartë të derës.




5.8 Lidhja elektrike

Në fund të instalimit mund të futni spinën në prizë.

Pllaka e specifikimeve dhe kapitulli "Të dhënat teknike" tregojnë specifikimet e nevojshme elektrike. Sigurohuni që të jenë në pajtim me rrjetin kryesor elektrik.

Kontrolloni që instalimi elektrik i shtëpisë suaj mund ta përballojë ngarkesën maksimale të kërkuar, duke marrë parasysh çdo pajisje tjetër në përdorim.

Lidhni pajisjen në një prizë me tokëzim.



Kundër-magneti

Pajisja është parapërgatitur për një mbyllje magnetike.

Për mbylljen e duhur:

1. Pozicionojeni vidën **C** dhe kundër-magnetin **D** në pllakën magnetike **N**. Anojeni derën e dollapit kundrejt vidës derisa të lërë një shenjë.
2. Hapni derën e dollapit dhe vidhosni kundër-magnetin **D** (disku i çelikut + unaza prej gome **E**) me vidën **C** në anën e brendshme të derës së dollapit, ku vida ka lënë shenjën e përkthyer në hapin e parë.



Fiksues fleksibël për pajisje

Bllokuesi plastik i përfshirë mund të instalohet vetëm kur të ketë përfunduar instalimi i pajisjes, për të shmangur lëvizjen për jashtë. Fiksojeni në mobilie, pranë panelit të përpamë duke marrë si referencë për lartësinë mesin e derës, **në anën e kundërt të menteshave**.


Kabllloja e rrjetit elektrik duhet të jetë lehtësisht e arritshme pas instalimit të pajisjes.

Për punimet elektrike që nevojiten për instalimin e kësaj pajisjeje, kontaktoni me qendrën tonë të autorizuar të shërbimit.

Prodhuuesi nuk pranon asnjë përgjegjësi për dëmtimin ose lëndimin nga mosrespektimi i masave të mësipërme paraprake të sigurisë.


6. PANELI I KONTROLLIT

6.1 Përshkrimi i panelit të kontrollit



- 1** Çelësi i programit
- 2** Spin butoni me prekje
- 3** Temperature butoni me prekje
- 4** Ekran
- 5** Delay Start butoni me prekje dhe funksioni Remote Start
- 6** Time Manager butoni me prekje
- 7** Start / Pause butoni me prekje
- 8** Plus Steam Butoni me prekje dhe opsioni i Bllokimit për fëmijët
- 9** Soft Plus butoni me prekje
- 10** Extra Rinse butoni me prekje
- 11** Stains butoni me prekje
- 12** On/Off butoni me shtypje
- 13** Prewash butoni me prekje

6.2 Ekran



	Zona e temperaturës: 88° Treguesi i temperaturës . --* Treguesi i ujit të ftohtë.
	Treguesi i kyçjes së sigurisë për fëmijët.
	Treguesi i lidhjes Wi-Fi.
	Treguesi i Nisjes në distancë.
	Treguesi i derës së mbyllur.
	Treguesi i nisjes me vonesë.
	Treguesi dixhital mund të tregojë: - Kohëzgjatjen e programit (p.sh. 2:40). - Koha e vonesës (p.sh. 2h). - Përfundimin e ciklit (0:00). - Kodin e paralajmërimit (p.sh. E20). - Treguesi i gabimit (— — —). - Kur punoni me aplikacionin: APP, AP (pika e aksesit), UPd (përditësimi). Ju lutemi shikoni kapitullin "Konfigurimi i lidhjes së Wi-Fi". - Trguesi i orëve totale të punës të pajisjes. Referojuni seksionit 'Numëruesi i orëve të punës' në paragrafin 'Cilësimet' për më shumë detaje.
-----	Treguesi i Time Manager.
	Treguesi i UltraCare.
	Treguesin e fazës me avull.
	Treguesi i fazës kundër rrudhave.
	Treguesi i pastrimit të kazanit. Ky është rekomandim për të kryer një pastrim të kazanit.
	Zona e centrifugës: Treguesi i shpejtësisë së centrifugimit — — — Treguesi Pa centrifugim. Faza e centrifugimit është çaktivizuar.
	Treguesi i Silent.
	Treguesi i ndërprerjes së shpëlarjes.
	Treguesi i shtimit të rrobave. Ndizet në fillim të fazës së larjes, kur është ende e mundshme që pajisja të vendoset në pauzë dhe të shtohen më shumë rroba.
	Treguesi i peshës maksimale (referojuni paragrafit "Zbulimi i ngarkesës së SensiCare System"). MAX Pulson kur ngarkesa e rrobave tejkalon ngarkesën maksimale të deklaruar të programit të përzgjedhur.

7. ÇELËSI PËRZGJEDHËS DHE BUTONAT

7.1 Hyrje



Opsionet/funksionet nuk janë të disponueshme për gjithë programet e larjes. Kontrolloni përputhshmërinë midis opsioneve/funksioneve dhe programeve të larjes në "Tabelën e programeve". Një opsjon/funksion mund të përjashtojë një tjetër, në këtë rast pajisja nuk ju lejon të vendosni opsione/funksione të papajftueshme.

7.2 On/Off

Shtypni këtë buton për pak sekonda për të aktivizuar ose çaktivizuar pajisjen. Dëgjohen dy tinguj të ndryshëm gjatë ndezjes ose fikjes së pajisjes.

Ndërsa funksion i Pritjes aktive e çaktivizon automatikisht pajisjen pas disa minutash për të ulur konsumin e energjisë, mund t'ju nevojitet ta aktivizoni sërish pajisjen.

Për më shumë detaje, referojuni paragrafit "Pritja aktive" në kapitullin "Përdorimi i përditshëm".

7.3 Çelësi i programeve

Për të vendosur programin e dëshiruar të larjes. Referojuni kapitullit "Programet" për hollësi të mëtejshme.

Pozicioni • është funksion "Rivendosjeje", i cili ndalon dhe rivendos programin që është në punë. Ekranin shfaq vija boshe për të treguar se nuk është zgjedhur asnjë program.

7.4 Temperature

Kur përzgjidhni një program larjeje, pajisja propozon automatikisht një temperaturë të parazgjedhur.

Prekeni këtë buton në mënyrë të përsëritur derisa të shfaqet vlera e dëshiruar e temperaturës në ekran.

Kur ekranin shfaq treguesit --*, pajisja nuk e ngroh ujin.

7.5 Spin

Kur vendosni një program, pajisja cilëson automatikisht shpejtësinë e parazgjedhur të centrifugimit të programit. Me këtë opsjon mund të pakësoni shpejtësinë e parazgjedhur të centrifugimit.

Prekeni këtë buton në mënyrë të përsëritur që të:

- **Ulini shpejtësinë e centrifugimit.** Ekranin tregon vetëm shpejtësitë e disponueshme të centrifugimit për programin e vendosur.
- Opsionet shtesë të centrifugimit **Pa**

centrifugim — —.

Vendosni këtë opsjon për të çaktivizuar të gjitha fazat e centrifugës. Pajisja kryen vetëm fazën e shkarkimit të programit të zgjedhur të larjes. Vendosni këtë opsjon për tekstile shumë delikate. Faza e shpëlarjes përdor më shumë ujë për disa programe larjeje

- Aktivizoni opsjonin **Ndërrprerje e shpëlarjes**

Nuk është kryer centrifugimi i fundit. Uji i shpëlarjes së fundit nuk do të shkarkohet për të evituar zhubrosjen e rrobave. Programi i larjes përfundon me ujë në kazan.

Treguesi mbetet i afishuar. Dera qëndron e kyçur dhe kazanin rrotullohet rregullisht për të reduktuar rrudhosjen. Duhet të zbrazni ujin për të hapur derën.

Nëse prekeni butonin Start / Pause , pajisja kryen një fazë centrifugimi dhe shkarkon ujin.



Pajisja e zbraz ujin automatikisht pas afro 18 orësh.

- Aktivizoni **Silent** opsjonin. Të gjitha fazat e centrifugimit të ndërmjetme dhe përfundimtare anulohen dhe programi përfundon me ujë në kazan. Kjo ndihmon për të reduktuar rrudhosjen.

Treguesi mbetet i afishuar. Dera e furrës qëndron e mbyllur. Kazanin rrotullohet rregullisht për të reduktuar

rudhosjen. Duhet të zbrazni ujin për të hapur derën.

Duke qenë se programi është shumë i heshtur, është i përshtatshëm për t'u përdorur gjatë natës kur disponohen edhe tarifa më të lira për energjinë elektrike. Në disa programe, shpëlarjet kryhen me më shumë ujë.

Nëse prekni butonin Start / Pause , pajisje kryhen vetëm fazën e shkarkimit.



Pajisja e zbraz ujin automatikisht pas afro 18 orësh.

7.6 Prewash

Me këtë option mund të shtoni një fazë të para-larjes në një program të larjes.

Treguesi korrespondues mbi butonin me prekje ndizet.

Përdoreni këtë funksion për të shtuar një fazë paralarjeje në 30 °C përpara fazës së larjes.

Ky option rekomandohet për rrobat shumë të ndotura, veçanërisht nëse përmbajnë rërë, pluhur, baltë dhe grimca të tjera të ngurta.



Optionsi mund të rrisë kohëzgjatjen e programit.

7.7 Stains

Prekni këtë buton për të shtuar fazën e njollave në një program.

Treguesi korrespondues mbi butonin me prekje ndizet.

Përdoreni këtë option për rrobat për larje me njolla të që janë të vështira për t'u hequr.

Kur cilësoni këtë option, vendosni heqësin e njollave në ndarje .

Heqësi i njollave përzihet paraprakisht dhe ngrohet me detergjentin për të përmirësuar efikasitetin e vet.



Ky option rrit kohëzgjatjen e programit. Ky option nuk është i disponueshëm me një temperaturë më të ulët se 40°C.

7.8 I përherëshëm Extra Rinse

Me këtë option mund të shtoni disa shpëlarje sipas programit të zgjedhur të larjes.

Përdoreni këtë option për personat me alergji ndaj mbetjeve të detergjentit dhe me lëkurë të ndjeshme.



Ky option rrit kohëzgjatjen e programit.

Treguesi korrespondues mbi butonin me prekje ndizet dhe qëndron gjithashtu i ndezur gjatë cikleve të mëvonshme derisa ky option të çaktivizohet.

7.9 I përherëshëm Soft Plus

Vendosni këtë option për të optimizuar shpërndarjen e zbutësit të rrobave dhe për të përmirësuar butësinë e rrobave.

Rekomandohet kur përdorni zbutësin e rrobave.



Ky option rrit kohëzgjatjen e programit.

Treguesi korrespondues mbi butonin me prekje ndizet dhe qëndron gjithashtu i ndezur gjatë cikleve të mëvonshme derisa ky option të çaktivizohet.

7.10 Plus Steam

Ky program shton një fazë avulli të ndjekur nga një fazë e shkurtër kundër rrudhave në fund të programit të larjes.

Faza e avullit redukton rrudhat e rrobave dhe lehtëson hekurosjen e tyre.

Treguesi korrespondues mbi butonin me prekje ndizet.

Treguesi  qëndron i ndezur gjatë fazës së avullit.



Ky option mund të rrisë kohëzgjatjen e programit.

Kur ndalon programi ekrani tregon , treguesi  fiket dhe treguesi  dhe Start /

Pause  Ilampa qëndrojnë të ndezura.]. Kazani kryen lëvizje të buta për rreth 30 minuta për të ruajtur efektet e avullit. Duke prekur secilin buton, lëvizjet kundër rrudhave ndalojnë dhe dera hapet, paisja sërish propozon programin e mëparshëm.

Për të ndaluar fazën kundër rrudhave, ju mund të:

- Shtypni butonin On/Off  për disa sekonda për të aktivizuar ose çaktivizuar pajisjen.
- Kthimi i celësit të programit në një pozicion tjetër.



Një ngarkesë e vogël rrobash ndihmon që të arrihen rezultate më të mira.

7.11 Bllokimi për fëmijët

Me këtë opsion mund të parandaloni që fëmijët të luajnë me panelin e kontrollit.

- Për të **aktivizuar/çaktivizuar** këtë opsion, mbani shtypur butonin  derisa  të **ndizet/fiket** në ekran.

Pajisja do të kalojë si parazgjedhje te ky opsion pasi e fikni.

7.12 Delay Start

Me këtë opsion mund ta shtyni fillimin e programit deri në një kohë më të të volitshme.

Prekni në mënyrë të përsëritur butonin për të vendosur shtyrjen e kërkuar. Koha rritet me hapa prej 1 ore deri në 20 orësh.

Në ekran shfaqet treguesi  dhe koha e zgjedhur e shtyrjes. Pasi prekni butonin Start / Pause , pajisja fillon numërimin mbrapsht dhe dera është e kyçur.

7.13 Time Manager

Me këtë opsion mund të zvogëloni kohëzgjatjen e programit në varësi të madhësisë së ngarkesës dhe nivelit të ndotjes.

Kur vendos një program larjeje, ekrani tregon kohëzgjatjen e parazgjedhur dhe ----- vija.

Prekni butonin Time Manager  për të reduktuar kohëzgjatjen e programit sipas nevojave tuaja. Ekran shfaq kohëzgjatjen e re të programit dhe një numër vijash do të ulen përkatësisht:

----- e përshtatshme për një ngarkesë të plotë me rroba me ndotje normale.

---- një cikël i shpejtë për një ngarkesë të plotë me rroba me ndotje të ulët.

-- cikël shumë i shpejtë për ngarkesë të vogël me ndotje të ulët (rekomandohet maks. një gjysmë ngarkese).

- cikli më i shkurtër për të freskuar një sasi të vogël rrobash.

Time Manager është i disponueshëm vetëm me programet në tabelë.

treguesi

	Cottons	Synthetics
----- 1)	■	■
----	■	■
---	■	■
-- 2)	■	■
- 2)	■	■

1) Kohëzgjatja e parazgjedhur për të gjitha programet.

2) Ky nivel i opsionit Time Manager nuk është i disponueshëm në 90°C.

Time Manager me programet me avull

Kur vendosni një program me avull, ky buton ju lejon të zgjidhni tri nivele avulli dhe kohëzgjatja e programit reduktohet përkatësisht:

- ---- : maksimumi.
- -- : mesatare.
- - : minimumi.

7.14 Start / Pause

Shtypni butonin Start / Pause  për të filluar, vendosur në pauzë ose ndërprerë një program që është në punë.



Imazhi i vogël  do të thotë se mund ta ndaloni ciklin dhe të shtoni ose hiqni rrobat. Lexoni seksionin 'Hapja e derës - Shtimi i rrobave' për më shumë detaje.

8. PROGRAMET

8.1 Skica e programeve

Programi Temperatura e parazgjedhur Diapazoni i temperaturës	Shpejtësia referencë e centrifugimi t Gama e shpejtësisë së centrifugimi t	Ngarkes a maksim ale	Përshkrimi i programit (Lloji i ngarkesës dhe niveli i ndotjes)
Programet e larjes			
Eco 40-60 40°C 1)	1400 rpm (1400 - 400 rpm)	8.0 kg	Të pambuktat e bardha dhe me ngjyra të shpejta. Artikuj të ndotur normalisht. Konsumi i energjisë ulet dhe koha e programit të larjes zgjatet, duke siguruar rezultate të mira në larje.
Cottons 40°C 90°C - Ftohtë	1400 rpm (1400 - 400 rpm)	8.0 kg	Të pambuktat e bardha dhe me ngjyra. Artikuj me ndotje normale, të madhe dhe të lehtë.
Synthetics 40°C 60 °C - I ftohtë	1200 rpm (1200 - 400 rpm)	3.0 kg	Artikuj sintetikë ose tekstile të përziera. Artikuj të ndotur normalisht.
Delicates 30°C 40 °C - I ftohtë	1200 rpm (1200 - 400 rpm)	2.0 kg	Tekstile delikate të tilla si akrilike, viskoze dhe tekstile të përziera kërkojnë larje më delikate. Artikuj me ndotje normale dhe të lehtë.
Programet e avullit  me Sistemin FreshScent			
  Steam Cashmere		1.0 kg	Lesh dhe kashmir. Program i shkurtër për të freskuar pa larje maksimumi 1.0 kg rroba leshi dhe kashmiri që mund të lahen me dorë ose me makinë. Kur trajtoni ngarkesa më të vogla, kohëzgjatja e programit mund të reduktohet më tej përmes Time Manager opsionit .
 PARALAJMËRIM! Mos e përdorni këtë program për rroba të leshta me etiketën vetëm për pastrim kimik.			

Programi Temperatura e parazgjedhur Diapazoni i temperaturës	Shpejtësia referencë e centrifugimi t Gama e shpejtësisë së centrifugimi t	Ngarkes a maksim ale	Përshkrimi i programit (Lloji i ngarkesës dhe niveli i ndotjes)
--	--	-------------------------------	--



Steam FreshScent

1.0 kg

Të pambukta, Sintetike, Delikate. Program i shkurtër dhe delikat me avull për të freskuar edhe rrobat më delikate, duke përfshirë rroba shumë delikate me temina, dantella etj. Kur trajtoni ngarkesa më të vogla, kohëzgjatja e programit mund të reduktohet më tej përmes Time Manager opsionit .



PARALAJMËRIM!

Mos e përdorni këtë program me rroba të leshta dhe me etiketën vetëm për pastrim kimik.



PARALAJMËRIM!

Mos përdorni detergjent!

Programet e veçanta

Spin/Drain	1400 rpm (1400 - 400 rpm)	8.0 kg	Të gjitha tekstilet, përveç të leshtave dhe tekstileve delikate. Për të centrifuguar rrobat dhe për të shkarkuar ujin e kazanit.
Rinse	1400 rpm (1400 - 400 rpm)	8.0 kg	Të gjitha tekstilet, përveç të leshtave dhe tekstileve shumë delikate. Program për të shpëlarë dhe për të centrifuguar rrobat. Shpejtësia e parazgjedhur e centrifugimit është ajo që përdoret për programet e pambukut. Reduktojeni shpejtësinë e centrifugimit sipas llojit të rrobave. Nëse është e nevojshme, caktoni Extra Rinse opsionin për të shtuar shpëlarje. Me një shpejtësi të ulët centrifugimi, pajisja kryen shpëlarje delikate dhe centrifugim të shkurtër.

Programe shtesë larjeje

 Hygiene 60°C	1400 rpm 1400 rpm - 400 rpm	8.0 kg	Artikuj të bardhë të pambuktë. Ky program i larjes me performancë të lartë i kombinuar me avuj të avullit, heq më shumë se 99,99% të baktereve dhe viruseve ²⁾ mbajtja e temperaturës mbi 60 °C gjatë gjithë fazës së larjes; me një veprim shtesë mbi fibrat falë një faze avulli, një fazë shpëlarje e përmirësuar siguron heqjen e duhur të mbetjeve të detergjentit dhe mikroorganizmave. Ky program siguron gjithashtu një zvogëlim të duhur të poleneve/artikujve alergjentë.
Rapid 14min 30°C	1200 rpm (1200 - 400 rpm)	1.5 kg	Tekstile sintetike dhe të përziera. Artikuj të ndotur pak dhe artikuj për të rifreskuar.
UltraWash 59min 30°C 60°C - 30°C	1400 rpm (1400 - 400 rpm)	4.0 kg	Artikuj të pambuktë. Program intensiv për të siguruar performancën më të mirë brenda një kohe të shkurtër.

Programi Temperatura e parazgjedhur Diapazoni i temperaturës	Shpejtësia referencë e centrifugimi t Gama e shpejtësisë së centrifugimi t	Ngarkes a maksim ale	Përshkrimi i programit (Lloji i ngarkesës dhe niveli i ndotjes)
 Outdoor 30°C 40 °C - I ftohtë	1200 rpm (1200 - 400 rpm)	2.0 kg ³⁾ 1.0 kg ⁴⁾	 Mos përdorni zbutës rrobash dhe sigurohuni që kenë mbetur mbetje zbutësi në folenë e detergjentit. Artikuj sportivë sintetikë. Ky program është projektuar për të larë butësisht rrobat moderne sportive që përdoren jashtë dhe është gjithashtu i përshtatshëm për rrobat e palestrës, çiklizmit apo vrapimit ose artikuj të ngjashëm. Ngarkesa e rekomanduar për rrobat është 2.0 kg. Tekstile të papërshkueshme nga uji dhe të papërshkueshme nga uji që e lejojnë shkëmbimin e ajrit. Ky program mund të përdoret dhe si fazë për rikthimin e papërshkueshmërisë së ujit, projektuar veçanërisht për trajtimin e rrobave me shtresë hidrofobike. Për të kryer fazën e rikthimit të papërshkueshmërisë së ujit, veproni si vijon: • Derdhni detergjentin e largës në ndarjen . • Derdhni një restaurues special papërshkueshmërie nga uji për pëlhura në folenë e zbutësit të rrobave të sirtarit . • Pakësoni ngarkesën e rrobave në 1.0 kg.  Për të përmirësuar më tej veprimin e restaurimit të papërshkueshmërisë së ujit, thajini rrobat në një tharëse rrobash duke vendosur Outdoor programin e tharjes (nëse disponohet dhe nëse etiketa e rrobave lejon tharjen në tharëse rrobash).
Denim 30°C 40 °C - I ftohtë	800 rpm (1200 - 400 rpm)	3.0 kg	Program special për xhinse me fazë delikate larjeje për të minimizuar zbehjen e ngjyrave dhe shenjat. Për kujdes më të mirë, rekomandohet një ngarkesë e reduktuar.

Programi Temperatura e parazgjedhur Diapazoni i temperaturës	Shpejtësia referencë e centrifugimi t Gama e shpejtësisë së centrifugimi t	Ngarkes a maksim ale	Përshkrimi i programit (Lloji i ngarkesës dhe niveli i ndotjes)
--	--	-------------------------------	--

 Wool / Silk 40°C 40 °C - I ftohtë	1200 rpm (1200 - 400 rpm)	1.5 kg	Të leshta që lahen në makinë larëse, të leshta që lahen me dorë dhe tekstile të tjera me simbolin e kujdesit "larje me dorë" ⁵⁾ .
---	------------------------------	--------	--

1) Sipas Rregullores 2019/2023 të Komisionit të BE-së, ky program në 40 °C mund të pastrojë rrobat me ndotje normale të deklaruar se mund të lahen në 40 °C ose 60 °C, së bashku në të njëjtin cikël.



Për temperaturën e arritur në roba, kohëzgjatjen e programit dhe të dhënat e tjera, ju lutemi shikoni kapitullin "Vlerat e konsumimit".

Programet më efikase në lidhje me konsumin e energjisë janë në përgjithësi ato që performojnë në temperatura më të ulëta dhe kohëzgjatje më të gjata.

- 2) I testuar për Staphylococcus aureus, Enterococcus faecium, Candida albicans, Pseudomonas aeruginosa dhe MS2 Bacteriophage në testin e jashtëm të kryer nga Swisstest Testmaterialien AG në vitin 2021 (Raporti i Testit Nr. 202120117).
- 3) Programi i larjes.
- 4) Programi i larjes dhe faza e papërshkueshmërisë nga uji.
- 5) Gjatë këtij cikli kazani rrotullohet ngadalë për të garantuar larje delikate. Mund të duket që kazani nuk rrotullohet fare ose nuk rrotullohet mirë, por është normale për këtë program.

Pajtueshmëria e opsioneve të programit

Programi	Spin	Pa centrifugim			Prewash ¹⁾	Stains ²⁾	Extra Rinse	Soft Plus	Plus Steam	Delay Start	Time Manager
Eco 40-60	■		■							■	
Cottons	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
Synthetics	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
Delicates	■	■	■	■			■	■		■	
 Steam Cashmere										■	■

Programi	Spin	Pa centrifugim			Prewash ¹⁾	Stains ²⁾	Extra Rinse	Soft Plus	Plus Steam	Delay Start	Time Manager
 Steam FreshScent										■	■
Spin/Drain	■	■ ³⁾								■	
Rinse	■	■	■				■			■	
 Hygiene	■	■	■		■	■	■	■	■	■	
Rapid 14min	■	■	■							■	
UltraWash 59min	■	■	■				■	■		■	
 Outdoor	■	■	■				■			■	
Denim	■	■	■	■		■	■	■	■	■	
 Wool / Silk	■	■	■							■	

1) Prewash dhe Stains nuk mund të zgjidhen bashkë.

2) Ky opsion nuk është i disponueshëm në temperaturë më të ulët se 40°C.

3) Nëse caktoni opsionin Pa centrifugim, pajisja vetëm shkarkon ujin.

Detergjentë të përshtatshëm për secilin program

Programi	Pluhur universal ¹⁾	Lëng universal	Lëng për rroba me ngjyra	Delikate të lehta	Special
Eco 40-60	▲	▲	▲	--	--
Cottons	▲	▲	▲	--	--
Synthetics	▲	▲	▲	--	--
Delicates	--	--	--	▲	▲
 Hygiene	▲	▲	--	--	▲
Rapid 14min	--	▲	▲	--	--
UltraWash 59min	▲	▲	▲	--	--

Programi	Pluhur universal ¹⁾	Lëng universal	Lëng për rroba me ngjyra	Delikate të leshta	Special
 Outdoor	--	--	--	▲	▲
Denim	--	--	▲	▲	▲
 Wool / Silk	--	--	--	▲	▲

1) Në temperaturë më të lartë se 60 °C rekomandohet përdorimi i detergjentit pluhur.

▲ = Rekomandohet

-- = Nuk rekomandohet

8.2 Steam programet

Programet Steam mund të përdoren për pakësimin e rrudhave dhe erërave në rroba (si të pambukta, sintetike, pëlhura të përziera, përfshirë delikatet) që thjesht kanë nevojë të rifreskohen, në një kohë të shkurtër, duke shmangur larjen.

Fibrat e rrobave relaksohen dhe më pas hekurosja bëhet dhe plotësisht e lehtë. Kur cikli përfundon, hiqni shpejt rrobat nga kazani.

Kohëzgjatja e ciklit mund të pakësohet deri në 15 minuta përmes opsionit Time Manager



MOS e cilësoni këtë regjim me llojet e mëposhtme të artikujve:

- Artikujt që nuk janë të përshtatshëm për tharjen në tharëse.
- Artikujt me etiketën "Vetëm për pastrim kimik".



Mos përdorni detergjent!

Programet Steam nuk heqin erën veçanërisht të rëndë dhe nuk kryejnë ndonjë cikël higjenik.

Pas trajtimit me avull, rrobat mund të jenë të lagëta. Varini rrobat jashtë për pak minuta.

Aroma (Electrolux FreshScent System)

FreshScent System ju lejon të freskoni edhe rrobat tuaja delikate, duke hequr rrudhat dhe duke shtuar freski me një aromë të butë të krijuar ekskluzivisht nga **Electrolux**. Duke freskuar rrobat tuaja me avull sesa përdorimin e cikleve të plotë të larjes, do t'i mbani rrobat tuaja të dukeshin dhe të ndjehen të reja më gjatë. Madje mund të përdorni me siguri aromën me programet Kashmir dhe Avull - nëse janë në dispozicion - për pëlhura delikate si kashmir dhe lesh. Kur trajtoni ngarkesë të vogël, pakësoni dozën e aromës dhe kohëzgjatjen e ciklit: në vetëm pesëmbëdhjetë minuta rrobat tuaja do të rimarrin atë ndjenjë të "sapo-larjes".

Lexoni me kujdes instruksionet e ofruara bashkë me aromën.

MOS:

- Thani në tharëse rrobat e trajtuara me fragrancë. Dobitë e saj do të largohen me avullin.
- Përdorni fragrancën për qëllime ndryshe nga ato që përshkruhen këtu.
- Përdorni fragrancën në rroba të reja. Rrobat e reja mund të përmbajnë përbërës mbetjesh që nuk janë të përshtatshme për atë.



Aroma është e disponueshme në dyqanin në internet **Electrolux** ose nga shitësi i autorizuar.

8.3 Woolmark Premium Wool Care - E gjelbër



Cikli i larjes për të leshtat në këtë makinë është analizuar dhe miratuar nga The Woolmark Company për larjen e rrobave të leshta që mbajnë etiketën për «larje me dorë» nëse produktet lahen sipas udhëzimeve në etiketën e rrobës dhe ato të dhëna nga prodhuesi i kësaj makine larëse.
M1756

9. 📶 WI-FI - KONFIGURIMI I LIDHJES

Ky kapitull përshkruan mënyrën si të lidhni pajisjen smart me rrjetin Wi-Fi dhe me pajisjet celulare.

Përmes këtij funksioni mund të merrni njoftime, mund të kontrolloni dhe monitoroni pajisjen tuaj nga pajisjet celulare.

Funksionaliteti Wi-Fi është joaktiv si cilësim i paracaktuar i fabrikës.

Për të lidhur pajisjen që të përfitonin nga gama e plotë e veçorive dhe e shërbimeve, ju nevojiten:

- Rrjet me valë në shtëpi, me lidhje interneti të aktivizuar.
- Pajisje celulare e lidhur me rrjetin me valë.

Parametrat e modulit Wi-Fi

Frekuenca	2.412 - 2.472 GHz për tregun evropian
Protokolli	IEEE 802.11b/g/n
Fuqia maksimale	<20 dBm
Enkriptimi	WPA, WPA2, WPA3

9.1 Instalimi dhe konfigurimi i App



App ju lejon të kontrolloni larjen e rrobave përmes një pajisjeje celulare.

Ai përmban një numër të madh programesh, veçorish të dobishme dhe informacionesh produkti të përshtatura në mënyrë të përkryer për pajisjen.

Përmes aplikacionit ju mund të zgjidhni programet që janë tashmë të disponueshme nga paneli i kontrollit të pajisjes, plus shkyçni programe shtesë të disponueshme vetëm nga një pajisje celulare.

Programet shtesë mund të ndryshojnë me kalimin e kohës, së bashku me versionet e reja të aplikacionit.

Është kujdes i personalizuar për rrobat - gjithçka nga pajisja juaj celulare.

Kur lidhni pajisjen me aplikacionin, qëndroni pranë saj me pajisjen tuaj celulare.


Sigurohuni që pajisja celulare të jetë e lidhur me rrjetin me valë të shtëpisë.

1. Shkoni në App Store në pajisjen tuaj inteligjente ose skanoni kodin QR (*shih paragrafin 'Kodi QR në pllakën e të dhënave'*).
2. Shkarkoni dhe instaloni aplikacionin tonë.
3. Sigurohuni që të keni nisur një lidhje Wi-Fi në pajisje. Nëse jo, lexoni paragrafin e radhës "Konfigurimi i lidhjes me valë të pajisjes".

- Nisni aplikacionin. Zgjidhni vendin dhe gjuhën dhe identifikohuni me emailin dhe fjalëkalimin tuaj. Nëse nuk keni një llogari, krijoni një të re duke ndjekur udhëzimet në App.
- Ndiqui udhëzimet në aplikacion për regjistrimin dhe konfigurimin e pajisjes.

9.2 Konfigurimi i lidhjes me valë të lavatriçes

- Shtypni butonin On/Off  për pak sekonda për të aktivizuar pajisjen. Prisi rreth 10 sekonda përpara se të vazhdoni me konfigurimin e lidhjes me valë.
- Zgjidhni një program duke rrotulluar çelësin e programeve.
- Shtypni dhe mbani shtypur butonat  dhe  për pak sekonda njëkohësisht derisa të dëgjohet një "klikim". Lëshojini butonat. **On** shfaqet në ekran për 5 sekonda dhe treguesi  fillon të pulsojë. Moduli me valë fillon të niset.



Sigurohuni që APLIKACIONI është gati për lidhjen.

- Pas rreth sekondash, shfaqet në ekran **AP** (Pika e hyrjes).




Pika e hyrjes do të hapet për rreth 3 minuta.



Për sa kohë që pajisja është e aktivizuar, ajo do të vazhdojë të provojë të lidhet me kredencialet e ruajtura derisa Wi-Fi të çaktivizohet ose rivendos kredencialet.

- Konfiguroni aplikacionin "My Electrolux" në pajisjen tuaj dhe ndiqni udhëzimet për të lidhur pajisjen me rrjetin tuaj Wi-Fi.
- Nëse është konfiguruar lidhja, kur kthehet ekran i informacionit të programit, treguesi  shfaqet në ekran.



Për të çaktivizuar lidhjen me valë, prekni butonat  dhe  për pak kohë njëkohësisht derisa të bjerë sinjali i parë akustik. Lëshojini butonat. **OFF** shfaqet në ekran për 5 sekonda.



Nëse e fikni dhe rindizni pajisjen, lidhja me valë fiket automatikisht.

Për të hequr kredencialet e lidhjes me valë, shtypni dhe mbani shtypur butonat  dhe  për 10 sekonda njëkohësisht derisa sinjali i parë akustik: **---** shfaqet në ekran.

9.3 Ndezja në distancë

Nisja në distancë ju mundëson të ndizni një cikël me kontrollin në distancë.



Kontrolli në distancë aktivizohet automatikisht kur shtypni butonin Start / Pause  për të nisur programin, por është e mundur që të niset një program larjeje në distancë.

Kur është instaluar aplikacioni dhe është kryer lidhja me valë, mund të aktivizoni Nisjen në distancë:

1. Prekni butonin Remote Start  dhe treguesi APP shfaqet në ekran për pak sekonda.



2. Prekni butonin Start / Pause  për të aktivizuar Nisjen në distancë përpara se treguesi APP të ndalojë së pulsuar.

Treguesit  dhe  shfaqen në ekranin e përmbledhjes së programeve dhe dera kyçet. Tani është e mundur të nisni programin në distancë.



Kur prekni butonin Start / Pause  pasi treguesi APP ndalon së pulsuar, Nisja në distancë nuk aktivizohet, por programi i vendosur ndizet.

Për të hequr Nisjen në distancë, prekni butonin Remote Start  dhe konfirmoni duke shtypur butonin Start / Pause .



Pozicioni i rivendosjes • çaktivizon Nisjen në distancë.

9.4 Përditësimi në ajër

Aplikacioni mund të propozojë një përditësim për pajisjen tuaj.

Përditësimi pranohet vetëm përmes aplikacionit.

Nëse është në funksionim një program, aplikacioni njofton se përditësimi do të nisë në përfundim të programit.

Gjatë përditësimit, pajisja shfaq  në ekran.

Mos e fikni ose hiqni nga priza pajisjen gjatë përditësimit.

Pajisja do të jetë sërish e përdorshme në përfundim të përditësimit, pa ndonjë njoftim rreth përditësimit të suksesshëm.

Nëse ndodh një gabim, pajisja shfaq  në ekran: thjesht shtypni çdo buton ose ktheni çelësin për t'iu kthyer përdorimit normal.

10. CILËSIMET

10.1 Sinjalet akustike

Kjo pajisje ka sinjale të ndryshme akustike, që veprojnë kur:

- Aktivizoni pajisjen (sinjal i shkurtër i veçantë).
- Çaktivizoni pajisjen (sinjal i shkurtër i veçantë).
- Prekni butonat (tingull klikimi).
- Bëni përzgjedhjen e gabuar (3 tinguj të shkurtër).
- Programi përfundon (sekuencë tingujsh për rreth 2 minuta).
- Programi ka keqfunksionim (sekuencë tingujsh të shkurtër për rreth 5 minuta).

Për të **aktivizuar/çaktivizuar** sinjalet akustike kur përfundon programi, prekni

njëkohësisht butonat  dhe  për rreth 2 sekonda. Në ekran shfaqet Ndezje ose Fikje.



Nëse çaktivizoni sinjalet akustike, ato vazhdojnë të punojnë kur pajisja ka keqfunksionim.

10.2 Matësi i orëve të punës

Mund të shikoni kohën totale të punës së pajisjes në orë, duke filluar që nga ndezja e parë. Kjo vlerë do të matë kohën e punës së cikleve (nuk përfshin kohën e pushimeve, kohën e shtyrjes së programit). Për të parë këtë vlerë, vepmoni si vijon:

1. Ndizeni pajisjen duke shtypur On/Off butonin.
2. Rrotullojeni çelësin e programit në Eco 40-60 programin (pozicioni i parë në drejtimin e akrepave të orës).
3. Shtypni dhe mbani të shtypni butonin Prewash dhe Stains për disa sekonda (brenda 10 sekondave pas ndezjes. Pas këtyre 10 sekondave, aktivizohet kombinimi i çelësit dhe çaktivizon sinjalet akustike).
4. Pas 3 sekondash, orët totale të punës së pajisjes tregohen në ekran: p.sh. 1276 orë, ekrani tregon tekstin Hr për 2 sekonda, 12 (mijëra dhe qindra) për 2 sekonda dhe 76 (dhjetëra dhe njësi).



Nëse procedura nuk funksionon (për shkak të ndërprerjes, pozicionit të gabuar të fushës së programit ose kombinimit të gabuar të çelësit), fiken pajisjen dhe përsëriteni sekuencën nga fillimi.

10.3 Rivendosja në gjendje fabrike

Ky funksion lejon të rikthehen opsionet e paracaktuara të fabrikës. Për të **aktivizuar** këtë opsion ndiqni hapat më poshtë:

1. Ndizeni pajisjen duke shtypur On/Off butonin.
2. Rrotullojeni çelësin e programit në Synthetics programin (pozicioni i tretë në drejtimin e akrepave të orës).
3. Shtypni dhe mbani të shtypni butonin Prewash dhe Stains për disa sekonda (brenda 10 sekondave pas ndezjes. Pas këtyre 10 sekondave, aktivizohet kombinimi i çelësit dhe çaktivizon sinjalet akustike).
4. Ekran do të shfaqë — — për rreth 5 sekonda.



Nëse procedura nuk funksionon (për shkak të ndërprerjes, pozicionit të gabuar të fushës së programit ose kombinimit të gabuar të çelësit), fiken pajisjen dhe përsëriteni sekuencën nga fillimi.

11. PËRPARA PËRDORIMIT TË PARË

1. Sigurohuni që të disponohet energjia elektrike dhe që rubineti i ujit të jetë i hapur.
 2. Derdhni 2 litra ujë në folenë e detergjentit të shënuar me .
- Ky veprim aktivizon sistemin e shkarkimit.
3. Derdhni një sasi të vogël detergjenti në folenë e detergjentit të shënuar me .

4. Vendosni dhe startoni një program për të pambuktat në temperaturën më të lartë pa rroba në kazan.
- Kjo do të heqë të gjitha papastërtitë e mundshme nga tamburi dhe kazani.

12. PËRDORIMI I PËRDITSHËM



PARALAJMËRIM!

Referojuni kapitujve për sigurinë.

12.1 Aktivizimi i pajisjes


1. Futeni spinën në prizë.
2. Hapni rubinetin e ujit.

3. Shtypni butonin On/Off për pak sekonda për të aktivizuar pajisjen. Tingëllon një melodi e shkurtër.

12.2 Mbushja e ngarkesës

1. Hapni derën e pajisjes.

2. Zbrazni xhepat dhe shpalosni rrobat artikujt përpara se t'i vendosni ato brenda pajisjes.
3. Vendosni rrobat në kazan, një nga një. Mos fusni shumë rroba në kazan.
4. Mbyllni derën fort.




KUJDES!

- Sigurohuni që të mos ngecin rroba mes guarnicionit dhe derës për të shmangur rrezikun e rrjedhjes së ujit dhe dëmtimit të rrobave.

- Larja e njollave tepër të ndotura me vaj dhe graso ose përdorimi i parfumeve mund të shkaktojë dëmtim të pjesëve prej gome të makinës rrobolarëse.

12.3 Mbushja me detergjent dhe aditivë



- Ndarja për fazën e paralarjes, programin e njomjes ose heqjen e njollave.



- Ndarja për fazën e larjes.



- Ndarja e zbutësit të rrobave dhe trajtimeve të tjera me lëngje (solucion rrobash, niseshte).

MAX - Niveli maksimal i sasisë së aditivëve të lëngshëm.



- Ndarësja për detergjentin pluhur ose të lëngshëm.




Gjithmonë zbatoni udhëzimet që gjeni tek ambalazhi i produkteve të detergjentit, por rekomandojmë që të mos tejkaloni nivelin maksimal të treguar (**MAX**). Kjo sasi garanton rezultatet më të mira në larje.




Pas një cikli larjeje, nëse është e nevojshme, hiqni mbetjet e detergjentit nga kutia e detergjentit.

12.4 Kontrolloni pozicionin e ndarësës të detergjentit

1. Tërhiqni lart folenë e detergjentit derisa të ndalojë.




2. Shtypni levën poshtë për ta hequr folenë.
3. Për të përdorur detergjent pluhur, ktheni kapakun lart.
4. Për të përdorur detergjent lëng, ktheni kapakun poshtë.



Me ndarësen në pozicionin **POSHTË**:

- Mos përdorni detergjentë xhelatinozë ose detergjentë prej lëngu të trashë.
- Mos e tejkaloni dozën e detergjentit të lëngshëm që tregohet në ndarje.
- Mos e caktoni opsionin e paralarjes.
- Mos e vendosni funksionin e shtyrjes së programit.

5. Matni sasinë e detergjentit dhe të zbutësit të robave.
6. Mbylleni me kujdes folenë e detergjentit.



Sigurohuni që kapaku të mos shkaktojë bllokim kur të mbyllni sirtarin.

12.5 Vendosja e një programi

1. Rrotulloni çelësin e programeve për të zgjedhur programin e dëshiruar të larjes. Eco 40-60 është programi me të cilin lidhet informacioni i etiketës së energjisë.

Treguesi i Start / Pause ►|| butonit pulson. Ekрани tregon kohëzgjatjen e përafërt të programit.

2. Prekni butonat përkatës për të ndryshuar temperaturën dhe/ose shpejtësinë e centrifugimit.
3. Nëse dëshironi, vendosni një ose më shumë opsione duke prekur butonat përkatës. Treguesit përkatës do të ndizen

dhe informacioni i dhënë do të ndryshojë në ekran përkatësisht.



Nëse nuk **mund të kryhet** një përzgjedhje, bie një sinjal akustik dhe ekrani shfaq — — —.

12.6 Nisja e një programi

Prekni butonin Start / Pause ►|| për të nisur programin. Programi nuk mund të nisët kur treguesi i butonit është i çaktivizuar dhe nuk pulson (p.sh. çelësi i programeve në pozicion të gabuar).

Treguesi përkatës ndalon së pulsuar dhe qëndron i ndezur.

Programi fillon, dera mbyllet. Ekрани tregon treguesin ►|| dhe simboli ►|| shfaqet për të treguar se është ende e mundur të ndaloni ciklin dhe të shtoni veshje.



Pompa e shkarkimit mund të punojë pak përpara se pajisja të mbushet me ujë.

12.7 Nisja e një programi me shtyrjen e programit

1. Prekni butonin Delay Start ►|| në mënyrë të përsëritur derisa ekrani të shfaqë kohën e dëshiruar të vonesës. Në ekran treguesi shfaq ►||
2. Prekni butonin Start / Pause ►||. Dera e pajisjes kyçet dhe fillon numërimi mbrapsht të shtyrjes së programit. Ekрани shfaq treguesin ►||.

Kur përfundon numërimi mbrapsht, programi fillon automatikisht.

Anulimi i shtyrjes së programit pasi ka nisur numërimi mbrapsht

Për të anuluar shtyrjen e programit:

1. Prekni butonin Start / Pause ►|| për të vendosur pajisjen në pauzë. Pulson treguesi përkatës.

2. Prekni butonin Delay Start  në mënyrë të përsëritur derisa ekrani tregon  dhe treguesi  fiket.
3. Prekni sërish butonin Start / Pause  për të nisur menjëherë programin.

Ndryshimi i shtyrjes së programit pasi ka nisur numërimi mbrapsht

Për të ndryshuar shtyrjen e programit:

1. Prekni butonin Start / Pause  për të vendosur pajisjen në pauzë. Pulson treguesi përkatës.
2. Prekni butonin Delay Start  në mënyrë të përsëritur derisa ekrani të shfaqë kohën e dëshiruar të vonesës.
3. Prekni sërish butonin Start / Pause  për të nisur një numërim të ri mbrapsht.

12.8 Dallimi i ngarkesës me SensiCare System



Kohëzgjatja e programit në ekran i referohet një **ngarkese të mesme/të lartë**.

Pas prekjes së butonit Start / Pause , çaktivizohet treguesi i ngarkesës maksimale të deklaruar, SensiCare System fillon dallimin e ngarkesës së rrobave:

1. Pajisja e dallon ngarkesën brenda 30 sekondave të para. Në programet ku Time Manager është e disponueshme, gjatë kësaj faze shiritat, Time Manager  që gjenden poshtë shifrave të treguesit të kohës, luajnë një animacion të thjeshtë. Kazani rrotullohet për pak kohë.
2. Kohëzgjatja e programit mund të rregullohet përkatësisht dhe mund të shtohet ose të ulet. Pas 30 sekondave të tjera, fillon mbushja me ujë.

Pasi përfundon dallimi i ngarkesës, **në rast mbingarkese të kazarit**, treguesi **MAX** pulson në ekran:

Në këtë rast, për 30 sekonda, pajisja mund të vendoset në pauzë dhe mund të hiqen rrobat e tepërta.

Pasi hiqen rrobat e tepërta, prekni butonin Start / Pause  për të nisur sërish programin. Faza SensiCare mund të përsëritet deri në tri herë (shikoni pikën 1).

E rëndësishme! Nëse nuk do të reduktohet sasia e rrobave, programi i larjes fillon gjithsesi, pavarësisht mbingarkesës. Në këtë rast, nuk do të jetë e mundur të garantohen rezultatet më të mira të larjes.



20 minuta pas nisjes së programit, kohëzgjatja e programit mund të përshtatet sërish në varësi të kapacitetit të thithjes së ujit nga rrobat.



Dallimi me SensiCare kryhet vetëm në programet e plota të larjes dhe nëse kohëzgjatja e programit nuk është reduktuar përmes butonit Time Manager.



SensiCare System nuk është e disponueshme në të gjitha programet, si p.sh. Wool / Silk, Rinse, apo programet me cikle të shkurtra.

12.9 Ndërprerja e programit dhe ndryshimi i opsioneve

Kur programi është në punë, mund të ndryshoni **vetëm disa** opsione:

1. Prekni butonin Start / Pause  Pulson treguesi përkatës.
2. Ndryshoni opsionet. Informacioni i dhënë në ekran ndryshon përkatësisht.
3. Prekni sërish butonin Start / Pause  Programi i larjes vazhdon.

12.10 Anulimi i një programi në punë

1. Shtypni butonin On/Off  për të anuluar programin dhe për të çaktivizuar pajisjen.
2. Shtypni përsëri butonin On/Off  për të aktivizuar pajisjen.



Nëse SensiCare System ka përfunduar dhe mbushja me ujë ka filluar tashmë, programi i ri fillon **pa përsëritur SensiCare System**. Uji dhe detergjenti nuk shkarkohen për të shmangur shpërdorimin. Ekran shfaq kohëzgjatjen maksimale të programit, duke e përditësuar atë rreth 20 minuta pas nisjes së programit të ri.

Ekziston edhe një mënyrë alternative për anulimin:

1. Rrotullojeni çelësin përzgjedhës në pozicionin "Reset" (Rivendos) • .

2. Pritni për 1 sekondë. Ekran tregon --- . Tani mund të vendosni një program të ri larjeje.

12.11 Hapja e derës - Shtimi i rrobave

Kur programi ose shtyrja e programit janë në punë, dera e pajisjes është e kyçur.



Nëse temperatura dhe niveli i ujit në kazan janë shumë të larta dhe/ose kazani vazhdon të rrotullohet, ju nuk mund ta hapni derën.

Mund ta hapni lehtësisht derën për shtimin ose heqjen e disa artikujve kur ikona është e ndezur.

1. Prekni butonin Start / Pause . Në ekran fiket treguesi përkatës i kyçjes së derës.
2. Hapni derën e pajisjes. Nëse është e nevojshme, shtoni ose hiqni artikujt.
3. Mbyllni derën dhe prekni butonin Start / Pause .

Vazhdon programi ose shtyrja e tij.

Kur ikona fiket, dera mund të hapet kur programi të ketë përfunduar. Gjithashtu mund të caktoni një program/opsion shkarkimi dhe më pas shtypni butonin Start / Pause . Nëse programet e centrifugimit dhe të shkarkimit nuk disponohen në diskun e programeve, ata mund të vendosen përmes aplikacionit.

12.12 Përfundimi i programit

Kur programi të ketë përfunduar, pajisja fiket automatikisht. Sinjalet akustike funksionojnë, (nëse janë aktive). Ekran shfaq .

Treguesi i butonit Start / Pause fiket.

Dera zhblokohet dhe treguesi fiket.

1. Shtypni butonin e On/Off për të çaktivizuar pajisjen.

Pesë minuta pas përfundimit të programit, funksioni i kursimit të energjisë e çaktivizon automatikisht pajisjen.



Kur e aktivizoni pajisjen përsëri, ekran tregon fundin e programit të mëparshëm. Rrotullojeni çelësin e programeve për të vendosur një cikël të ri.

2. Nxirrni nga pajisja rrobat.
3. Sigurohuni që kazani të jetë bosh.
4. Mbajeni derën dhe folenë e detergjentit paksa të hapur, për të parandaluar mykun dhe erërat e pakëndshme.

12.13 Shkarkimi i ujit jashtë pas mbarimit të ciklit

Nëse keni zgjedhur një program ose një opsion që nuk e zbraz ujin e shpëlarjes së fundit, programi përfundon, por:

- Zona e kohës shfaq dhe ekran shfaq derën e kyçur .
- Treguesi i butonit Start / Pause fillon të pulsojë.
- Kazani vazhdon të rrotullohet me intervale të rregullta për të parandaluar rrudhat te rrobat.
- Dera e furrës qëndron e mbyllur.
- Duhet të shkarkoni ujin për të hapur kapakun:

1. Nëse është e nevojshme, prekni butonin Spin për të ulur shpejtësinë e centrifugimit të propozuar nga pajisja.
2. Shtypni butonin Start / Pause : pajisja shkarkon ujin dhe kryen centrifugimin. Zhduket treguesi i opsionit Ndërprerje e shpëlarjes ose .



Nëse keni caktuar Silent  dhe shpejtësia e centrifugimit nuk ndryshon, kur shtypni butonin Start / Pause , pajisja vetëm shkarkon ujin.

3. Kur programi mbaron dhe treguesi  i bllokimit të derës fiket, ju mund ta hapni derën.
4. Shtypni butonin On/Off  për pak sekonda për të çaktivizuar pajisjen.

12.14 Funksioni i gatishmërisë

Funksioni i gatishmërisë çaktivizon automatikisht pajisjen për të ulur konsumimin e energjisë kur:

- Nuk e përdorni pajisjen për 5 minuta kur nuk ka program në punë.
Shtypni butonin On/Off  për ta aktivizuar pajisjen sërish.
- 5 minuta pas përfundimit të programit të larjes.

Shtypni butonin On/Off  për ta aktivizuar pajisjen sërish.

Ekrani tregon përfundimin e programit të fundit.

Rrotullojeni çelësin e programeve për të vendosur një cikël të ri.

Nëse çelësi rrotullohet në pozicionin "Reset"

(Rivendosja) , pajisja fiket automatikisht pas 30 sekondash.



Nëse vendosni një program ose opsion që përfundon me ujë në kazan, funksioni i gatishmërisë **nuk çaktivizon** pajisjen për t'ju kujtuar të shkarkoni ujin.



Telekomanda pengon opsionin e Gatishmërisë, por pas 15 minutash pajisja hyn në regjimin e Gatishmërisë së rrjetit dhe ekrani shfaq vetëm treguesin



13. UDHËZIME DHE KËSHILLA



PARALAJMËRIM!


Referojuni kapitujve për sigurinë.

13.1 Ngarkesa e rrobave


- Ndajini rrobat në: të bardha, me ngjyra, sintetike, delikate dhe të lehta.
- Zbatoni udhëzimet e larjes në etiketat e kujdesit të rrobat.
- Mos lani së bashku rrobat e bardha dhe ato me ngjyrë.
- Disa rroba me ngjyra mund të zbehen gjatë larjes së parë. Rekomandojmë që t'i lani ato veçmas dy-tri herët e para.
- Kthejini së prapthi rrobat me disa shtresa, të lehtëta dhe veshjet me stampa.
- Trajtoni paraprakisht njollat e vështira.
- Lajini njollat e vështira me detergjent të veçantë.
- Bëni kujdes me perdet. Hiqini kapëset e tyre dhe futini perdet në një qese për larje apo këllëf jastëku.
- Një ngarkesë shumë e vogël mund të shkaktojë probleme balancimi gjatë fazës

së centrifugimit duke çuar në dridhje të tepërta. Nëse ndodh kjo:

- a. ndërprisni programin dhe hapni derën (referojuni kapitullit "Përdorimi i përditshëm");
 - b. rishpërndajeni me dorë ngarkesën në mënyrë që rrobat të shpërndahen njëtrajtësisht nëpër kazan;
 - c. shtypni butonin Start / Pause. Faza e centrifugimit vazhdon.
- Kopsitni këllëfët e jastëkëve, mbyllni zinxhirët, tokëzat dhe sustat. Lidhni rripat, kordonët, lidhëset e këpucëve, fjongot dhe çdo element tjetër të lirshëm.
 - Mos lani rroba pa tegela ose me prerje. Përdorni një trastë larjeje për të larë rroba të vogla dhe/ose delikate (p.sh. sytjena me tela, rripa, streçe, lidhëse këpucësh, fjongo etj.).



- Zbrazni xhepat dhe shpalosni rrobat.



13.2 Njollat e vështira

Për disa njolla, nuk mjafton uji dhe detergjenti.

Rekomandojmë që këto njolla t'i trajtoni përpara se të vendosni rrobat në pajisje.

Për këtë ka heqës të veçantë njollash. Përdorni heqës të veçantë njollash që i përshtaten llojit të njollës dhe pëlhurës.

Mos spërkatni heqës njollash mbi rrobat pranë pajisjes sepse është gërryes për pjesët plastike.



13.3 Lloji dhe sasia e detergjentit

Zgjedhja e detergjentit dhe përdorimi i sasive të duhura jo vetëm që ndikon te performanca në larje, por ndihmon gjithashtu edhe në shmangien e mbetjeve dhe mbrojtjen e mjedisit:

- Përdorni vetëm detergjente dhe trajtime të tjera të prodhuara posaçërisht për

lavatriçe. Së pari, ndiqni këto rregulla të përgjithshme:

- detergjentë pluhur (gjithashtu tableta dhe detergjentë me doza të vetme) për të gjitha llojet e pëlhurës, me përjashtim të delikateve. Preferohen detergjente pluhur që përmbajnë zbardhues për higjienizimin e të bardhave dhe rrobave të palara,
- detergjentet lëngje (gjithashtu detergjentë me doza të vetme), mundësisht për programe me temperatura të ulta të larjes (60 °C maksimumi) për të gjitha llojet e pëlhurave ose të posaçme vetëm për të leshtat.
- Zgjedhja dhe sasia e detergjentit varen nga: lloji i tekstilit (delikate, të leshta, pambuk etj.), ngjyra e rrobave, madhësia e ngarkesës, niveli i ndotjes, temperatura e larjes, koha dhe fortësia e ujit të përdorur.
- Ndiqni udhëzimet që gjeni tek ambalazhi i detergjenteve ose trajtimeve të tjera pa tejkaluar nivelin e treguar maksimal (**MAX**).
- Mos përzieni lloje të ndryshme detergjentësh.
- Përdorni më pak detergjent, nëse:
 - po lani një sasi të vogël rrobash,
 - kohëzgjatja e programit është pakësuar nga butoni i Menaxhimit të kohës.
 - rrobat nuk janë shumë të ndotura,
 - formohet shumë shkumë gjatë larjes.
- Kur përdorni tableta ose pods të detergjentit, gjithmonë futini brenda në kazan, jo në sirtarin e detergjentit dhe ndiqni rekomandimet e prodhuesit.

Detergjenti i pamjaftueshëm mund të shkaktojë:

- rezultate të pakënaqshme larjeje,
- ngarkesa e larjes bëhet gri,
- rroba me yndyrë,
- myk në pajisje.

Detergjenti i tepërt mund të shkaktojë:

- prodhim të tepërt shkume,
- efekt larjeje të reduktuar,
- shpëlarje të pamjaftueshme,
- ndikim më të madh në mjedis.

13.4 Këshilla për kursim

Për të kursyer ujë, energji dhe detergjent, rekomandojmë që të ndiqni këto këshilla:

- **Rrobat me ndotje normale** mund të lahen **pa larje paraprake** në mënyrë që të kurseni detergjent, ujë dhe kohë.
- Mbushja e pajisjes deri në **kapacitetin maksimal që tregohet për secilin prej programeve ndihmon në reduktimin e konsumit të energjisë dhe ujit**.
- Me paratrajtimin e duhur, njollat dhe ndotja e kufizuar mund të hiqen; rrobat në vijim mund të lahen në temperaturë më të ulët.
- Për të përdorur sasinë e duhur të detergjentit, referojuni sasisë së sugjeruar nga prodhuesi i detergjentit dhe kontrolloni fortësinë e ujit të sistemit tuaj shtëpiak. Referojuni paragrafi "Fortësia e ujit".
- Nëse keni një tharës me centrifugë, sugjerohet të përdorni **shpejtësinë**

maksimale të mundshme të

centrifugimit për programin e zgjedhur të larjes në mënyrë që të kurseni energji gjatë tharjes.

- Preferohet të përdorni cikle të shkurtra në temperatura më të ulët.

13.5 Fortësia e ujit

Nëse uji në zonën tuaj është i fortë ose mesatarisht i fortë, rekomandojmë të përdorni aditiv zbutës uji për makinat larëse.

Në zonat ku uji është i butë nuk është e nevojshme të përdorni zbutës uji.

Kontaktoni me autoritetet lokale të ujësjellësit për të mësuar fortësinë e ujit.

Përdorni sasinë e duhur të zbutësit të ujit. Zbatoni udhëzimet që gjeni tek ambalazhi i produktit.

14. KUJDESI DHE PASTRIMI



PARALAJMËRIM!

Referojuni kapitujve për sigurinë.

14.1 Programi i pastrimit periodik

Pastrimi periodik ndihmon në zgjatjen e jetëgjatësisë së pajisjes.

Pas çdo cikli, mbajeni derën dhe folenë e detergjentit paksa të hapur që të ketë qarkullim të ajrit dhe që të thani lagështirën brenda pajisjes: kjo do të parandalojë mykun dhe aromat e këqija.

Nëse pajisja nuk do të përdoret për një kohë të gjatë: mbyllni rubinetin e ujit dhe shkëputni pajisjen nga rrjeti elektrik.

Programi tregues i pastrimit periodik:

Heqja e çmërsit	Dy herë në vit
Larja e mirëmbajtjes	Një herë në muaj
Pastrimi i guarnicionit të derës	Çdo dy muaj
Pastrimi i kazanit	Çdo dy muaj

Pastrimi i folesë së detergjentit	Çdo dy muaj
Pastrimi i filtrit të pompës së shkarkimit	Dy herë në vit
Pastrimi i tubit të hyrjes së ujit dhe filtrit të valvulës	Dy herë në vit

Paragrafët e mëposhtëm shpjegojnë se si duhet ta pastroni secilën pjesë.

14.2 Heqja e objekteve të huaja



Sigurohuni që xhepat të jenë bosh dhe të gjitha elementet e lira të jenë lidhur përpara se të vini në punë ciklin. Referohuni tek "Ngarkesa e rrobave" te "Udhëzime dhe këshilla".

Hiqni çdo objekt të huaj (si p.sh. kapëse metalike, kopsa, monedha etj.) që mund të gjeni në guarnicionin e derës, filtra dhe kazan. Referohuni tek paragrafët "Guarnicioni i derës me filtër me buzë të dyfishtë",

"Pastrimi i kazanit", "Pastrimi i pompës së shkarkimit" dhe "Pastrimi i tubit të hyrjes së ujit dhe filtrit të valvulës". Nëse është e nevojshme, kontaktoni me Qendrën e Autorizuar të Shërbimit.

14.3 Pastrimi i jashtëm

Pastrojeni pajisjen vetëm me ujë të ngrohtë dhe sapun të butë. Thajini plotësisht të gjitha sipërfaqet. Mos përdorni shtupa kruajtëse ose materiale të tjera gërvishëse.

KUJDES!

Mos përdorni alkool, tretës boje ose produkte kimike.

KUJDES!

Mos pastroni sipërfaqet metalike me detergjent me bazë klori.

14.4 Heqja e çmërsit



Nëse uji në zonën tuaj është i fortë ose mesatarisht i fortë, rekomandojmë që të përdorni një zbutës uji për makinat e larjes.

Kontrollojeni kazanin rregullisht për të kontrolluar për çmërs.

Detergjentet standarde përmbajnë agjentë për zbutjen e ujit, por rekomandojmë që të vini në punë një cikël me kazan bosh dhe një produkt kundër çmërsit.



Zbatoni gjithmonë udhëzimet që gjeni tek ambalazhi i produktit.

14.5 Larja e mirëmbajtjes


Përdorimi i përsëritur dhe i zgjatur i programeve me temperaturë të ulët mund të shkaktojë depozitime të detergjenteve, mbetje pushi, rritje të baktereve brenda kazanit. Kjo mund të krijojë aroma të këqija dhe myk. Për të eliminuar depozitimet dhe për të pastruar pjesën e brendshme të pajisjes, aplikoni një larje mirëmbajtjeje rregullisht (të paktën një herë në muaj).



Referojuni paragrafit "Pastrimi i kazanit".

14.6 Guarnicioni i derës me filtër me buzë të dyfishtë

Kjo pajisje është projektuar me **sistem shkarkues me vetëpastrim**, që i lejon fibrat e lehta të pushit që bien nga rrobat të shkarkohen jashtë bashkë me ujin. Kontrolloni rregullisht guarnicionin dhe, nëse është e nevojshme, pastrojeni siç përshkruhet në skemën e mëposhtme. Monedhat, kopsat, objektet e tjera të vogla mund të mblidhen në përfundim të ciklit.



Pastrojeni kur nevojitet, duke përdorur agjent pastrues me krem amoniaku pa gërvishur sipërfaqen e izolimit.



Respekttoni gjithmonë udhëzimet që gjeni tek ambalazhi i produktit.

Kontrolloni dhe hiqni objektet (nëse ka) që mund të ngecin në palosje.

Sigurohuni që të mos mbesin rroba ndërmjet guarnicionit dhe derës.

Përdorni një copë të njomë për të fshirë çdo papastërti ose mbetje uji prapa guarnicionit të derës pas mbarimit të ciklit të programit.

14.7 Pastrimi i kazanit

Kontrolloni kazanin rregullisht për të parandaluar depozitimet e padëshiruara.

Në kazan mund të formohen grumbullime ndryshku si pasojë e ndryshkjes së trupave të huaj nga larja apo nga uji i rubinetit që përmban hekur

Pastroni kazanin me produkte të posaçme për inoks.



Zbatoni gjithmonë udhëzimet që gjeni tek ambalazhi i produktit.

Mos e pastroni kazanin me produkte acide për heqjen e çmërsit, produkte gërryese që përmbajnë klor ose hekur apo me lesh teli.

Për pastrim të plotë:

1. Nxirrni të gjitha rrobat nga kazan.
2. Vini në punë një program Cottons me temperaturën më të lartë.
3. Shtoni një sasi të vogël detergjenti pluhur në kazanin bosh për të shpëlarë mbetjet e mundshme.




Ndonjëherë, në përfundim të një cikli ekrani mund të shfaqë ikonën . Ky është rekomandim për të kryer një "pastrim të kazanit". Pasi të jetë kryer pastrimi i kazanit, ikona zhduket.

14.8 Pastrimi i folesë së detergjentit


Për të parandaluar depozitimet e mundshme të detergjenteve të thara apo grumbullimin e zbutësit të rrobave dhe/ose formimin e mykut në sirtarin e detergjentit, çdo dy muaj kryeni procedurën e pastrimit siç përshkruhet në skemat e mëposhtme:

1. Hapni sirtarin. Shtypni kapësen poshtë siç tregohet në figurë dhe tërhiqeni.




2. Hiqni pjesën e sipërme të folesë së aditivit për të ndihmuar pastrimin dhe për ta larë në ujë të rrjedhshëm të ngrohtë, për të hequr gjurmët e detergjentit të


akumuluar. Pas pastrimit, vendoseni sërish pjesën e sipërme në vendin e vet.



3. Sigurohuni që të gjitha mbetjet e detergjentit të hiqen nga pjesa e sipërme dhe e poshtme e folesë. Përdorni një furçë të vogël për të pastruar follenë.



4. Futni sirtarin e detergjentit në udhëzuesit e vet dhe mbylleni. Vini në punë një program shpëlarjeje pa rroba në kazan.



14.9 Pastrimi i filtrit të pompës së shkarkimit

PARALAJMËRIM!

Hiqni spinën e pajisjes nga rrjeti elektrik.





Kontrolloni rregullisht filtrin e pompës së shkarkimit dhe sigurohuni që të jetë i pastër.

Pastrojeni pompën e shkarkimit nëse:

- Pajisja nuk e shkarkon ujin.

Veproni siç përshkruhet në skemat e mëposhtme për të pastruar filtrin e pompës:



- Kazani nuk rrotullohet.
- Pajisja bën një zhurmë të pazakontë për shkak të bllokimit të pompës së shkarkimit.
- Në ekran shfaqet kodi i alarmit **E20**.




PARALAJMËRIM!

- Mos e hiqni filtrin gjatë kohës që pajisja është në punë.
- Mos e pastroni pompën nëse uji në pajisje është i nxehtë. Prisni derisa uji të ftohet

1. Hapni kapakun e pompës.

2. Vendosni një enë të përshtatshme poshtë pompës së shkarkimit për të mbledhur ujin që del prej aty.

Mbani gjithmonë një leckë pranë për të fshirë çdo rrjedhje uji gjatë heqjes së filtrit.




3. Rrotullojeni filtrin 180 gradë në drejtim të kundërt të akrepave të orës për ta hapur, pa e hequr.


Lëreni ujin të dalë.

4. Kur ena të jetë mbushur plot me ujë, kthejeni filtrin në vend dhe boshatiseni enën.

5. Përsëritni hapat 3 dhe 4 derisa uji të ndalojë së dali.




6. Rrotullojeni filtrin në drejtim të kundërt të akrepave të orës për ta çmontuar




7. Nëse është e nevojshme, hiqni pushin dhe objektet nga foleja e filtrit.


Sigurohuni që helika e pompës të mund të rrotullohet. Nëse nuk rrotullohet, kontaktoni qendrën e autorizuar të shërbimit.



8. Pastroni filtrin poshtë rubinetit të ujit.



9. Vendoseni sërish filtrin në udhëzuesit e veçantë duke e rrotulluar në drejtim të akrepave të orës. Sigurohuni që filtri të jetë shtrënguar mirë për të shmangur rrjedhjet.



10. Mbyll kapakun e pompës.





Kur e shkarkoni ujin me procedurën e shkarkimit të emergjencës, ju duhet ta aktivizoni përsëri sistemin e shkarkimit:

1. Hidhni 2 litra ujë në ndarjen e larjes kryesore të shpërndarësit të detergjentit.
2. Nisni programin për të derdhur ujin.

14.10 Pastrimi i zorrës së futjes së ujit dhe filtrit të valvulës

Rekomandohet t'i pastroni të dy filtrat e zorrës së hyrjes së ujit dhe të valvulës dy

herë në vit për të hequr depozitimet që grumbullohen me kalimin e kohës. Veproni siç përshkruhet në skemat e mëposhtme për të pastruar filtrat:



14.11 Shkarkimi i emergjencës

Nëse pajisja nuk mund ta shkarkojë ujin, kryeni të njëjtën procedurë që përshkruhet në paragrafin "Pastrimi i pompës së shkarkimit". Nëse është e nevojshme, pastroni pompën.

Kur e shkarkoni ujin me procedurën e shkarkimit të emergjencës, ju duhet ta aktivizoni përsëri sistemin e shkarkimit:

1. Hidhni 2 litra ujë në folenë e larjes kryesore të folesë së detergjentit.
2. Nisni programin për të shkarkuar ujin.

14.12 Masat paraprake të parandalimit të brymës

Nëse pajisja është e instaluar në një zonë ku temperatura mund të arrijë vlera rreth 0° C ose të bjerë më poshtë, hiqni ujin e mbetur nga tubi i hyrjes së ujit dhe pompa e shkarkimit.

1. Hiqni spinën nga priza elektrike.
2. Mbyllni rubinetin e ujit.
3. Vendosni dy skajet e tubit të hyrjes së ujit në një enë dhe lëreni ujin të rrjedhë nga tubi.
4. Zbrazni pompën e shkarkimit. Referojuni procedurës së shkarkimit të emergjencës.
5. Kur pompa e shkarkimit të jetë e zbrazur, vendosni përsëri tubin e hyrjes së ujit.

⚠ PARALAJMËRIM!

Sigurohuni që temperatura të jetë më e lartë se 0 °C përpara se ta përdorni sërish pajisjen. Prodhuuesi nuk mban përgjegjësi për dëme të shkaktuara nga temperaturat e ulëta.

15. ZGJIDHJA E PROBLEMEVE

PARALAJMËRIM!

Referojuni kapitujve për sigurinë.

15.1 Kodet e alarmeve dhe defektet e mundshme

Pajisja nuk fillon ose ndalon gjatë punës. Së pari, përpikuni të gjeni një zgjidhje për problemin (shikoni tabelat).

PARALAJMËRIM!


Çaktivizojeni pajisjen përpara se të kryeni ndonjë kontroll.

Me disa probleme, ekrani tregon kodin e alarmit dhe butoni Start /

Pause  **mund të pulsojë në mënyrë të vazhdueshme:**



Nëse pajisja është e mbingarkuar, hiqni disa artikuj nga kazani dhe/ose mbani shtypur derën ndërsa prekni butonin Start / Pause derisa treguesi  të ndalojë së pulsuar (shikoni figurën më poshtë).



Problemi	Zgjidhja e mundshme
E 10 Pajisja nuk mbushet siç duhet me ujë.	• Sigurohuni që rubineti i ujit të jetë i hapur. • Sigurohuni që presioni i furnizimit me ujë të mos jetë shumë i ulët. Për këtë informacion, kontaktoni autoritetin tuaj lokal të ujit. • Sigurohuni që rubineti i ujit të mos jetë bllokuar. • Sigurohuni që tubi i furnizimit të mos ketë përdredhje, dëmtime apo përthyerje. • Sigurohuni që lidhja e tubit të furnizimit me ujë është e saktë. • Sigurohuni që filtri i tubit të furnizimit dhe filtri i valvulës të mos jenë të bllokuar. Shikoni 'Kujdesi dhe pastrimi'.

E20

Pajisja nuk e shkarkon ujin.

- Sigurohuni që tapa e lavamanit të mos jetë e bllokuar.
- Sigurohuni që tubi i shkarkimit të mos ketë përdredhje ose përrhyerje.
- Sigurohuni që filtri i shkarkimit të mos jetë i bllokuar. Pastroni filtrin, nëse është e nevojshme. Shikoni "Kujdesi dhe pastrimi".
- Sigurohuni që lidhja e tubit të shkarkimit të ujit të jetë e saktë.
- Cilësoni programin e shkarkimit nëse cilësoni një program pa fazën e shkarkimit. Nëse programi i shkarkimit nuk disponohet në fushën e programeve, ai mund të cilësohet përmes aplikacionit.
- Cilësoni programin e shkarkimit nëse cilësoni një opsion që përfundon me ujë në kazan.

E40

Dera e pajisjes është e hapur ose nuk është e mbyllur mirë.

- Sigurohuni që dera të jetë e mbyllur mirë.

E91

Avari e brendshme. Nuk ka komunikim ndërmjet elementeve elektronike të pajisjes.

- Programi nuk ka përfunduar siç duhet ose pajisja ka ndaluar shumë herët. Fikeni dhe rindizeni pajisjen.
- Nëse shfaqet sërish kodi i alarmit, kontaktoni Qendrën e Autorizuar të Shërbimit.

EKO

Furnizimi me energji është i paqëndrueshëm.

- Prisni derisa furnizimi me energji të jetë i qëndrueshëm.

EFO

Është aktivizuar pajisja kundër përmbytjes.

- Shkëpusni pajisjen dhe mbyllni rubinetin e ujit. Kontaktoni qendrën e shërbimit të autorizuar.

Nëse ekrani shfaq kode të tjera alarmi, çaktivizoni dhe aktivizoni pajisjen. Nëse problemi vazhdon, kontaktoni me Qendrën e Autorizuar të Shërbimit. Në rast të një problemi tjetër me pajisjen, kontrolloni tabelën e mëposhtme për zgjidhje të mundshme.

Problemi	Zgjidhja e problemit
Programi nuk fillon.	• Sigurohuni që spina kryesore të jetë e lidhur me prizën e rrjetit. • Sigurohuni që dera e pajisjes të jetë mbyllur mirë. • Sigurohuni që të mos keni siguresa të dëmtuara në kutinë e siguresave. • Sigurohuni që Start / Pause  të jetë prekur. • Nëse është vendosur fillim me vonesë, anuloni cilësimin ose prisni sa të përfundojë numërimi mbrapsht. • Çaktivizoni funksionin e bllokimit për fëmijët nëse është i ndezur. • Kontrolloni pozicionin e çelësit në programin e përzgjedhur.
Pajisja mbushet me ujë dhe e shkarkon atë menjëherë.	• Sigurohuni që tubi i shkarkimit të jetë në pozicionin e duhur. Tubi mund të jetë pozicionuar shumë poshtë. Shikoni "Udhëzime instalimi".

Problemi	Zgjidhja e problemit
Faza e centrifugimit nuk funksionon ose cikli i larjes zgjat më shumë se zakonisht.	- Vendosni programin e centrifugës. Nëse programi i shkarkimit nuk disponohet në fushën e programeve, ai mund të cilësohet përmes aplikacionit'. - Sigurohuni që filtri i shkarkimit të mos jetë i bllokuar. Pastroni filtrin, nëse është e nevojshme. Shikoni "Kujdesi dhe pastrimi". - Rregulloni manualisht artikujt në kazan dhe filloni përsëri fazën e centrifugës. Ky problem mund të shkaktohet nga problemet e ekuilibrit.
Ka ujë në dysHEME.	- Sigurohuni që bashkimet e tubave të ujit të jenë të shtrënguar dhe të mos ketë rrjedhje uji. - Sigurohuni që tubi i furnizimit me ujë dhe tubi i shkarkimit të mos kenë dëmtime. - Sigurohuni që të përdorni detergjentin dhe sasinë e duhur të tij.
Nuk mund të hapni derën e pajisjes.	- Sigurohuni që të mos jetë zgjedhur një program larjeje që përfundon me ujë në kazan. - Sigurohuni që programi i larjes të ketë mbaruar. - Vendosni programin e shkarkimit ose të centrifugimit nëse ka ende ujë në kazan. Nëse programet e centrifugimit dhe të shkarkimit nuk disponohen në diskun e programeve, ata mund të vendosen përmes aplikacionit. - Sigurohuni që pajisja furnizohet me energji. - Ky problem mund të shkaktohet nga një avari e pajisjes. Kontaktoni Qendrën e Autorizuar të Shërbimit. Nëse ju duhet të hapni derën, ju lutemi lexoni me kujdes "Hapja e derës në rast emergjence". - Sigurohuni që Remote Start Mode të mos jetë aktivizuar. Çaktivizojeni atë.
Ekrani nuk shfaq treguesin e valëve të internetit  .	- Kontrolloni sinjalin e internetit me valë. - Sigurohuni që lidhja internetit me valë është aktivizuar. Referojuni paragrafit "Konfigurimi i lidhjes së internetit me valë të makinës larëse" në kapitullin "Wi-Fi - Konfigurimi i lidhjes". - Kontrolloni rrjetin dhe ruterin e shtëpisë. - Rindizeni ruterin. - Kontaktoni me ofruesin e shërbimit të internetit me valë nëse ka probleme të tjera me rrjetin e internetit me valë.
Aplikacioni nuk mund të lidhet me pajisjen.	- Kontrolloni sinjalin e e internetit me valë. - Kontrolloni nëse pajisja inteligjente është e lidhur me rrjetin e internetit me valë. - Kontrolloni rrjetin dhe ruterin e shtëpisë. - Rindizeni ruterin. - Kontaktoni me ofruesin e shërbimit të internetit me valë nëse ka probleme me rrjetin e internetit me valë. - Pajisja, pajisja inteligjente ose të dyja, kanë nevojë të konfigurohen sërish sepse është instaluar një ruter i ri ose konfigurimi i ruterit ka ndryshuar.
Aplikacioni nuk mund të lidhet shpesh me pajisjen.	- Sigurohuni që sinjali i internetit me valë të arrijë deri te pajisja. Përpikuni ta lëvizni ruterin e shtëpisë sa më pranë pajisjes që të jetë e mundur ose konsideroni blerjen e një pajisjeje përforcuese për rrezen e internetit me valë. - Sigurohuni që sinjali i internetit me valë të mos ndërpritet nga mikrovala. Fikni mikrovalën. Shmangni përdorimin e mikrovalës dhe të telekomandës njëkohësisht.

Problemi	Zgjidhja e problemit
Ekrani tregon  . Të gjithë butonat janë joaktivë përveç butonit On/Off  .	Pajisja po shkarkon çdo përditësim të disponueshëm. Prisni derisa procesi i përditësimit të ketë përfunduar. Nëse e çaktivizoni pajisjen gjatë përditësimit, ajo vazhdon kur e aktivizoni pajisjen sërish.
Pajisja bën një zhurmë të pazakontë dhe dridhet.	- Sigurohuni që niveli i pajisjes të jetë i saktë. Shihoni "Udhëzime instalimi". - Sigurohuni që butonat e paketimit dhe/ ose të kalimit të jenë hequr. Shikoni "Udhëzime instalimi". - Shtoni më shumë rroba në kazan. Ngarkesa mund të jetë shumë e vogël.
Kohëzgjatja e programit rritet ose ulet gjatë punës së programit.	SensiCare System është në gjendje të përshtatë kohëzgjatjen e programit sipas llojit dhe sasisë së rrobave. Referojuni paragrafit "Dallimi i ngarkesës me SensiCare System" në kapitullin "Përdorimi i përditshëm".
Rezultatet e larjes nuk janë të kënaqshme.	- Rrisni sasinë e detergjentit ose përdorni një detergjent tjetër. - Përdorni produkte speciale për të hequr njollat e forta përpara se të lani rrobat. - Sigurohuni që të cilësoni temperaturën e saktë. - Ulni ngarkesën e rrobave.
Ka shumë shpumë në kazan gjatë ciklit të larjes.	Pakëson sasinë e detergjentit ose numrin e tabletave ose detergjentëve me dozë të vetme.
Pas ciklit të larjes, ka ende mbejtje detergjenti në sirtarin e detergjentit.	- Sigurohuni që fleta të jetë në pozicionin e duhur (LART për detergjent pluhur - POSHTË për detergjent të lëngshëm). - Sigurohuni që ta përdorni rutinë e detergjentit sipas udhëzimeve që jepen në këtë manual përdorimi.

Pas kontrollit, aktivizoni pajisjen. Programi vazhdon nga pika e ndërprerjes.

Nëse problemi ndodh përsëri, kontaktoni Qendrën e Autorizuar të Shërbimit.

Të dhënat e nevojshme për qendrën e shërbimit ndodhen në pllakën e specifikimeve.

15.2 Hapja e derës në rast emergjence

Në rast të shkëputjes së energjisë ose defekteve në funksionim, dera e pajisjes mbetet e kyçur. Programi i larjes vazhdon kur të rikthehet energjia. Nëse në rast defekti dera mbetet e kyçur, mund ta hapni atë duke përdorur funksionin e shkyçjes së emergjencës.

Përpara hapjes së derës:



KUJDES!

Ka rrezik djegieje! Sigurohuni që temperatura e ujit nuk është tepër e lartë dhe rrobat të mos jenë të nxehta. Nëse nevojitet, prisni derisa të ftohen.



KUJDES!

Rrezik plagosjeje! Sigurohuni që kazani të mos rrotullohet. Nëse nevojitet, prisni derisa kazani të ndalojë së rrotulluari.




Sigurohuni që niveli i ujit brenda në kazan të mos jetë shumë i lartë. Nëse nevojitet, kryeni zbrazjen e emergjencës (shikoni "Zbrazja e emergjencës" në kapitullin "Kujdesi dhe pastrimi").

Për të hapur derën, veproni si më poshtë:

1. Shtypni butonin e On/Off  për të fikur pajisjen.

2. Shkëputni spinën nga priza elektrike.
3. Tërhiqni një herë poshtë këmbëzën e zhblokimit të emergjencës. Tërhiqeni një herë sërish, mbajeni të tendosur dhe, ndërkohë, hapni derën e pajisjes. Aktivizuesi i zhblokimit të emergjencës ndodhet aty ku tregohet nga figura e mëposhtme.



4. Nxirrni rrobat dhe pastaj mbyllni derën e pajisjes.

16. VLERAT E KONSUMIT

16.1 Koment



Kodi QR në etiketën e energjisë të dhënë me pajisjen jep një lidhje interneti tek informacioni që lidhet me performancën e pajisjes në databazën e EU EPREL. Ruajeni etiketën e energjisë për referencë së bashku me manualin e përdorimit dhe të gjitha dokumentet e tjera që ofrohen me këtë pajisje.

Të njëjtin informacion mund ta gjeni gjithashtu në EPREL duke përdorur lidhjen <https://eprel.ec.europa.eu>, emrin e modelit dhe numrin e produktit që gjeni në pllakëzën e specifikimeve të pajisjes. Shikoni kapitullin “Përshkrim i produktit” për pozicionin e pllakëzës së specifikimeve.



Vlerat dhe kohëzgjatja e programit mund të variojnë në varësi të kushteve të ndryshme (p.sh. temperatura e dhomës, temperatura e ujit dhe presioni, madhësia e ngarkesës dhe lloji i rrobave, tensioni i furnizimit) dhe gjithashtu nëse ndryshoni cilësimin e parazgjedhur të një programi.

16.2 Sipas Rregullores së Komisionit të BE-së 2019/2023

Programi Eco 40-60	kg	kWh	Litra	hh:mm	%	°C	rpm ¹⁾
Ngarkesë e plotë	8.0	0.770	54.0	03:20	53.00	37.0	1351
Gjysmë ngarkese	4.0	0.430	44.0	02:25	53.00	32.0	1351

Programi Eco 40-60	kg	kWh	Litra	hh:mm	%	°C	rpm ¹⁾
Çerek ngarkese	2.0	0.180	34.0	02:25	54.00	24.0	1351

1) Shpejtësia maksimale e centrifugimit.

Konsumi i energjisë në regjime të ndryshme

Fikur (W)	Në gatishmëri (W)	Shtyrja e programit (W)	Gatishmëria në rrjet (W)
0.50	0.50	4.00	2.00 ¹⁾

Koha deri në fikje/Regjimi në pritje është maksimumi 15 minuta.

1) Konsumi i energjisë i funksionit të lidhur është rreth 17,5 kWh në vit. Për të shkëputur këtë funksion, ju lutemi shikoni kapitullin "Konfigurimi i lidhjes së Wi-Fi".

16.3 Programet e zakonshme

Programet	kg	kWh	Litra	hh:mm	%	°C	rpm
Cottons ¹⁾ 90°C	8.0	2.200	85.0	04:15	52.00	85.0	1400
Cottons 60°C	8.0	1.350	85.0	03:25	52.00	55.0	1400
Cottons ²⁾ 20°C	8.0	0.250	85.0	02:50	52.00	20.0	1400
Synthetics 40°C	3.0	0.650	75.0	02:25	35.00	40.0	1200
Delicates ³⁾ 30°C	2.0	0.360	50.0	01:10	35.00	30.0	1200
Wool 30°C	1.5	0.200	55.0	01:05	30.00	30.0	1200

1) E përshtatshme vetëm për larjen e tekstileve me ndotje të madhe.

2) I përshtatshëm për të larë rroba të pambukta, sintetike dhe të përziera me pak ndotje.

3) Gjithashtu vepron si cikël i larjes së shpejtë për rrobat e ndotura pak.

17. SHQETËSIME MJEDISORE

Ricikloni materialet me simbolin . Vendoseni paketimin në kutitë përkatëse për ta ricikluar. Ndhmoni në mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit të njeriut duke ricikluar mbeturinat e pajisjeve elektrike dhe

elektronike. Mos i hidhni pajisjet e shënuara me simbolin  me mbeturinat shtëpiake. Kthejeni produktin në qendrën tuaj lokale të riciklimit ose kontaktoni zyrrën tuaj komunale..









The software in this product contains components that are based on free and open source software. Electrolux gratefully acknowledges the contributions of the open software and robotics communities to the development project.

To access the source code of these free and open source software components whose license conditions require publishing, and to see their full copyright information and applicable license terms, please visit:
<http://electrolux.opensourcerepository.com> (folder NIUS)